ExLibris

E PËRJAVSHME LETRARE & KULTURORE

Themelues BUJAR HUDHRI
Kryeredaktore VIOLETA MURATI

E SHTUNË, 6 PRILL 2019. NUMËR 21. VITI I I BOTIMIT. ÇMIMI 50 LEKË. WWW.EXLIBRIS.AL EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL BOTIM I ONUFRI SHPK

Poeti, shkrimtari dhe dëshmitar i gjallë, i vuajteve në diktaturë, Visar Zhiti në një rrëfim mbi jetën, poezinë dhe letërsinë. Me një krijimtari intensive pas '90-ës, Zhiti sapo është vlerësuar në Itali me çmimin e karrierës për veprën "Nata është atdheu im", me reflektimin nga burgjet në universalizimin estetik të dhimbjes njerëzore..

VISAR ZHITI

HERMETIZMI YNË, JO SI AI EUROPIAN, MË I VRAZHDË, EKZISTENCIAL...

Skicë nga Bujar Kapllani

OPINION

A PO E MUND LETËRSIA GLOBALE LETËRSINË PËR FËMIJË NË SHQIPËRI?!

Nga Gëzim Tafa (fq. 12)



ΙΣΤΟΡΙΑ ΣΥΝΤΟΜΟΣ
ΤΟΥ ΣΟΥΛΙΟΥ
ΚΑΙ ΠΑΡΓΑΣ

Περιέχουσα τὴν Ἀρχαιότητα αὐτῶν, καὶ Ἡρωϊκὰς μετὰ τῶν Τουρκῶν Πολέμους, καὶ μάλιστα τοὺς, τοῦ Συλίου μετὰ τοῦ Ἀλῆ Πασιᾶ κατοίκου τῶν Ἰωαννίνων, καὶ ἡγεμόνος τῆς Γραικίας, καὶ Μακεδονίας.

Τόμος Πρῶτος.

Ἐν ΠΑΡΙΣΣΙΟΙΣ. κατὰ τὸ 1803.

LIBRI JO I ZAKONSHËM I SULIT DHE SULJOTËVE

Nga Aurel PLASARI (fq. 6)



STORIA
DI SULI E DI PARGA
CONTENENTE
La loro cronologia, le loro guerre e specialmente quelle de' Sulioti con Ali-Vbascià, Principe della Grecia
SCRITTA IN GRECO-VOLGARE
DA
ΒΤΚ ΨΟ ΦΞΗ ΛΑ, ΑΩΚΑ
E tradotta in lingua italiana
DAL RAGIONIERE
CARLO GHERARDINI MILANESE
Membro corrispondente dell' Accademia Jonia.

1819.

Milano. Dalla Tipografia di Giuseppe Borsani
Corso di Porta Orientale N. 656.

EKSPOZITA

DRIANT ZENELI

FËMIJËT E MINIERAVE TË BULQIZËS NË BIENALEN E VENECIAS

Nga Fatmira Nikolli (Fq. 13)

Ballkani i Luan Starovës
Dr. Silvana Leka (Fq. 10)

Zija Çela, narrativa dhe grotesku te "Goja e Botës"
Enton Bido (Fq. 11)

Shënime për romanin "Dashuritë e virgjëreshës Madalenë" të Ridvan Dibrës - Alba Kallogjeri (Fq. 9)

ARSHI PIPA

BIBLIOTEKA-MUSEUM E TIRANËS

(fq. 5)



MARIO VARGAS LLOSA

ELEMENTI I FSHEHUR

Letër një romancieri të ri

(Fq. 14)

SAMANTA SCHWEBLIN

IM VËLLA UALTER

tregim

BIBLIOTEKË

Poeti, shkrimtari dhe dëshmitar i gjallë, i vuajteve në diktaturë, Visar Zhiti në një rrëfim mbi jetën, poezinë dhe letërsinë. Me një krijimtari intensive pas '90-ës, Zhiti sapo është vlerësuar në Itali me çmimin e karrierës për veprën "Nata është atdheu im", me reflektimin nga burgjet në universalizimin estetik të dhimbjes njerëzore..

VISAR ZHITI

HERMETIZMI YNË, JO SI AI EUROPIAN, MË I VRAZHDË, EKZISTENCIAL...

Intervistoi: Violeta Murati

Jeni njeriu dhe shkrimtari në vëmendje të medias, së fundmi edhe për dosjen tuaj të dënimit në burgjet e diktaturës. Ka një kërshëri gati barbare për këtë. Të gjithë duan të dinë ç'ka ndodhur me ju, ndërsa e keni thënë tashmë të vërtetën tuaj nëpër libra. A mund të na tregoni pse vazhdojnë të jenë aq të kundërta raportet mes historisë, letërsisë dhe realitetit?

Në qoftë se është kështu, që jam vërtet në vëmendje të medias dhe për dosjen e dënimit tim, nuk më vjen mirë, përkundrazi, por do të doja të thosha se dosja s'është imja, por e atyre që e bënë. Është "punë" e frikshme dhe absurde, kafkiane, duket si e askujt dhe e të gjithëve, por gjithsesi ajo ka autorë të posaçëm. Dosjet janë "vepër" e mynxyrshme e atij grupi të njohurish dhe të panjohurish, denoncuesish dhe provokatorësh, operativësh të sigurimit të dikurshëm të shtetit, kryetarësh të degëve të punëve të brendshme dhe sekretarësh të parë, të hetuesve dhe atyre që kishin profesion torturat, të prokurorëve, gjykatësve dhe dëshmitarëve të rremë ose jo nëpër gjyqe, të komandave të burgjeve, komisarëve dhe deri te skuadrat e pushkatimit.

Prapë s'është e gjitha, sepse më në krye është Komiteti Qendror i Partisë sunduese, shefi i saj në majë dhe supershefat e tij makabër më tutje, deri te Stalini, Mao Ce Duni e Titoja, tek ideologjia e urrejtjes dhe politizimi i saj, te Lenini, madje edhe te Marksi, te doktrina dhe doktrinizimi delirant me paranoja kontinentale. Kërshëria për dosjet është barbarizuar, siç e thoni ju me të drejtë dhe qortueshëm, sepse nuk duan të shohin të keqen, por se sa keq e ke pasur ti, ai, ne. Kërshëri për të mos ditur përballjen ndaj së keqes, qëndresën, kundërshtitë dhe martirizimin, ndërkaq ka një fanatizëm egocentrik të dëmshëm dhe drejtësia vazhdon të jetë e mangët, drejtësi e padrejtë, pa fajtorë e përgjegjësi, pa ndjesa, dhembje e ndëshkime, së paku morale. Ka pasur dhe ka shpërdorim të dosjeve, kërcënime abuzuese që nga thashethemet kafeneve, parlamenti real i shqiptarëve dhe deri te kreu i shtetit. Nëpër librat e mi kam sjellë vuajtjen time, persekutimin tonë general, jetën nën diktaturë, veçanërisht në burg dhe pas tij, si dhe kalimin e gjatë posdiktatorial për te normaliteti që ende mbetet anormal, për tek ëndrra që vazhdimisht zbehet.

Më vjen mirë që thoni se e kam sjellë tashmë të vërtetën time, por ngul këmbë që s'është vetëm imja. Ne u hakmorëm ndaj së keqes dhe persekutimit duke sjellë urtësi e duke bërë letërsi dhe art, pikërisht atë që na e kishin ndaluar. Mendoj se raportet janë aq të kundërta mes historisë, letërsisë dhe realitetit, sepse ne nuk kemi bërë paqe me historinë tonë, madje e kemi ndarë me sherr duke pronësuar pjesë të saj nga pjesë të ndryshme të shoqërisë, gati me heronj të personalizuar, ndërsa letërsinë nuk e duam ashtu siç ajo e meriton, si jetë e jetës sonë, si pushtet tjetër, ai shpirtërori, pra më i forti, madje edhe atë sikur e kemi të ndarë dhe ruhen ende ato mendësi e ndjesi të traditës përjashtuese që mbolli regjimi, nuk pranohen sa duhet, aq sa ç'janë prurjet e begata si pasuri e përbashkët, prandaj edhe realiteti është si ne dhe ne nuk jemi më të mirë se ai.

Sapo keni marrë në Itali çmimin e karrierës, si krijues, për veprën "Nata është atdheu im", ku motivacioni shkon *nga burgjet në universalizimin estetik të dhimbjes njerëzore*... Krijimtaria juaj pas '90-ës në prozë dhe poezi është vërshuese. Çfarë reflektoni mbi këtë karrierë të pasur, të dhimbshme – e quani "fat"?

Thjesht kam shkruar. Kam treguar fatin tim. A mund ta quajmë këtë fat? U dënova me burg për shkrimet e mia dhe vazhdova të shkruaj edhe në burg fshehurazi, aq sa mundej atje. Kapja e tyre mund të ishte edhe asgjësim. Pata "fatin" të mbetem gjallë unë dhe poezitë e mia, dhe pas '90-ës pata mundësinë e botimit. Pra, u zhbë sentenca që më ndalonte dhe vazhdova të shkruaj poezi, tregime, romane, ese deri më tani dhe po, kam botuar jo pak, ndoshta çdo vit kam nxjerrë nga një libër, përfshij edhe përkthimet. Besoj se letërsia ime është vetvetja, udhëtim, arritje në Golgotë, kryqi dhe ringjallja ime, dhimbje dhe dashuri, megjithëse të gjitha letërsitë, sado të ndryshme, të tilla janë besoj. Ju më pyesni për çmimin letrar të sapomarrë në Itali. Më duket se është i teti që më jepet nga andej, ku kam botuar nja tre libra në prozë, tregime, dy romane dhe më shumë se dyfishin e tyre libra me poezi. Italia ndoshta është vendi që jep më shumë çmime në botë, është tejet bujare edhe me të huajt, patjetër edhe me shqiptarët apo me histori të përzier, teksa te ne më duket se janë mpakur çmimet vjetore në letërsi, kanë mbetur një-dy shtetërorë, një për librin më të mirë në prozë, po poezia, drama, kritika letrare, libri për fëmijë? – dhe tjetri për përkthimin. Bëhet mirë që jepen çmimet e panairit të librit nga shoqata e botuesve dhe që ka edhe një çmim me emrin "Kadare". Vitin që shkoi m'u botua në Itali përmbledhja me poezi dygjuhëshe "Nata është atdheu im", me përkthimin brilant të Elio Miracco-s. Pati jehonë edhe në media, shkroi gazeta më e madhe italiane "Corriere della sera". Dhe botuesi "Pazzini" e dërgoi në këtë festival poezie, pjesëmarrës në konkurrim, që në 13 prill bëhet ceremonia e çmimeve, ku jam i ftuar. Siç e vutë në dukje edhe ju, është parë si një dalje pindarike *nga burgjet e së kaluarës në universalizimin estetik të dhimbjes njerëzore*... Unë besoj se kjo është deviza e gjithë letërsisë sonë, dalje nga mbyllja. Të huajt, të tjerët më saktë, që kanë edhe letërsi më të mëdha se jona, Franca, Gjermania, SHBA-ja, Vendet Nordike, Greqia, etj., Italia e Dantes dhe e disa poetëve botërorë, nobelistëve, janë kaq vlerësues ndaj letërsisë sonë dhe është detyrë jona që ne, së pari, duhet ta besojmë që kemi letërsi të denjë e pastaj, prapë së pari, të dimë t'ua tregojmë të tjerëve. E përsëris, vetes mbi të gjitha. Skepticizmi e nënvleftësimet, fobia ndaj vlerave tona të përbashkëta ndoshta vijnë po aq sa nga padija dhe nga trashëgimia, ideologjike më shumë sesa kulturore. Ndonjëherë na duket si vazhdim i përndjekjes.



Duket sikur jeni ende në fillime, kur vjen fjala për një botim të ri, krijime të reja. Sapo keni botuar vëllimin me poezi në Rumani, "Flatra e mundur". Tjetër peizazh, sikur shkoni mbi jetën tuaj, tani të shkruar. Çfarë i nxit këto botime, pse në italisht dhe në rumanisht?

E thatë shumë bukur, çdo botim i ri duhet t'i ngjajë një fillimi të ri. Të dy këta libra me poezi, ai që doli në Itali dhe ky tjetri i porsadalë në Rumani, kanë edhe poezi të reja, të pabotuara ende në Shqipëri, por edhe poezi të njohura të miat. "Nata është atdheu im" u përzgjodh nga përgatitësi italian, kritiku i njohur letrar Ennio Grassi. Botimin në Rumani, "Flatra e mundur", e përmbushi përgatitësi dr. Luan Topçiu, një nga kritikët tanë më të mirë, i nivelit europian, duke e përkthyer së bashku me bashkëshorten, dr. Renata Melonashi-Topçiu.

Puna e Luanit në Rumani për kulturën shqiptare dhe letërsinë shqipe është e një rëndësie të veçantë dhe me nivel të lartë, më e madhe se e një akademie apo e një ambasade bashkë, që shpesh nuk e kupton rëndësinë e librit dhe të kulturës, aq të rëndësishme në marrëdhëniet mes popujve, aq më tepër që Shqipëria s'ka më të mirë se çfarë t'i tregojë Europës dhe botës.

Po, po, është shtuar kështu një peizazh tjetër imi, ku një flatër e mundur, siç u tha në përurimin e librit, endet nëpër natën që është atdhe, sipër maleve të dhembjes, ku moria e çmendur e yjeve përshkënditet ethshëm, teksa qielli përgatit flatrën tjetër, atë të agimit…

Më ka bërë përshtypje poezia "Foletë e zbrazëta", është e ashpër, me dhimbje, me reminishencë… Çfarë ka ndodhur, ç'përjetim është: kujtesë apo plagë?

Edhe unë e dua çastin dhe vendin e asaj poezie, e kam shkruar në Rumani, në Curtea de Arges. Kujtoj se pashë një rresht të gjatë folesh prej bari dhe balte në

një mur dhe më tronditi zbrazëtia e tyre ulëritëse, por edhe që nuk i kishin prishur. Pra, që kishte shpresa, dallëndyshet do të vinin me stinën e ardhme bashkë me gëzimet. Ato folé ashtu më dhanë imazhin e gjinjve të tokës dhe menjëherë m'u nëpërmendën gjinjtë prej Rozafe të gruas dhe drama e jetëve të tyre, sakrifica, pritja... Është një dënesë ballkanike. Më thanë se kur u recitua në Rumani nga një aktor i teatrit, kamerat kishin kapur edhe lot në sy.

Kthehemi mbrapsht si në një roman tuajin, ka një ecje mbrapsht aty... Në vitin 1973 u bëtë gati të nxirrni një libër me poezi, "Rapsodia e jetës së trëndafilave", por nuk mundët, ju dënuan. Akuza, poezi të trishtuara që flasin gjuhën e Ezopit kundër regjimit dhe socializmit. S'dua të ndalem në këtë pjesë, por për të pasur një kujtesë nga ju, në distancën e sotme, çfarë ishin këto poezi, çfarë frymëzimi?

Ishin poezitë e një të riu gjimnazist, student. Nuk ishin trakte. Nuk e mendoj si libër të pazakonshëm. Në gjeneratën time kishte emra që shkruanin shkëlqyer, që botimet i gjymtonin, por prapë vargje, strofa e poezi shpesh ngjanin me ato copat e mermerit, të gjetura nëntokë, një krah a këmbë, kokë të thyer etj., dhe ti mund të përfytyroje bukurinë e gjithë statujës. Ishte një kohë që të donte të statujtë, pa ndjenja dhe të gjymtuar, ndërkaq statujat janë edhe bosh përbrenda. Ne mundoheshim t'i vidheshim gjendjes. Mbase desha të sjell një tufë me trëndafila të prerë, por ende të gjallë. Lejomëni t'ju sjell një thënie të Umberto Eco-s, shkrimtar, semiolog, eseist, akademik, një nga mendimtarët më të mëdhenj të kohëve tona, që është në parathënien e dr. Luan Topçiut në librin "Flatra e mundur". Eco mendon se nuk jemi dënuar padrejtësisht dhe duke më cituar edhe mua, ja ç'thotë: "Për të justifikuar nevojën e dënimit, nuk është e nevojshme që një shkrimtar të veprojë si subjekt politik, por ashtu si Zenone, ai komploton në mënyrë aktive kundër tiranit. Shihet qartë në këtë libër rasti i Visar Zhitit: mjaftoi të shkruante poezi të konsideruara nga redaktorët e një shtëpie botuese "të trishtuara dhe hermetike", e pra, kundër regjimit. Pastaj, praktika i kaloi automatikisht Komitetit Qendror të Partisë Komuniste shqiptare e Ministrisë së Brendshme dhe Zhiti fitoi drejtësisht dhjetë vjet burg. Kjo poezi u shkakton frikë regjimeve autoritare e diktatoriale edhe nëse flet, si në rastin e Zhitit, edhe për trëndafila."

Nuk ka poezi të pafajshme në diktaturë. Ose do t'i dënojë diktatura, kur nuk janë për atë, ose do t'i dënojë e ardhmja, kur janë për diktaturën.

Dua të shtoj këtu se përmbledhja "Rapsodia e jetës së trëndafilave", pas konfiskimit, ka humbur. E kam kërkuar dhe nuk e kam gjetur. Poezi të saj kanë mbetur, por jo libri në formën e tij parake. Ndërkaq mua më kanë konfiskuar 39 fletore e blloqe me poezi e ditar, shënime e tregime dhe i kam kërkuar në Arkivin e Ministrisë së Punëve të Brendshme në Tiranë, si dhe në Degën e Punëve të Brendshme të Lushnjës, ku banoja, dhe të Kukësit, ku punoja. S'janë. Në dosje, jo dhe jo. Për herë të fundit ia kisha parë ndër duar hetuesit tim, Nexhat Selimit, gjatë hetuesive të rënda netëve. Nëse nuk i kanë djegur, mundësia më e madhe kjo, një mendje më thotë që mund t'i ketë mbajtur hetuesi si relikte, siç mbajnë gjahtarët lëkurën apo brirët e drerit të vrarë prej tyre.

Më dhimbet ditari dhe tregimet, që nuk i kam rishkruar dot.

Çfarë donit në rininë tuaj?

Rininë time, asgjë më shumë…

Cila është poezia që mbani mend, ajo e para e krijuar në burg? Nën ç'psikozë u krijua? Mund të na e thoni, a ishte poezi e cakut të ekzistencës?

Në tmerr, i porsaarrestuar, në qelinë nëntokë, dëshpërimisht të zbrazët, më të zbrazët se ato foletë prej balte e bari që folëm, edhe pse unë isha brenda, por i vrarë. Dera e rëndë e mbyllur brutalisht me hekur, ndiheshin hapat e këpucëve me gozhdë të policit. Dhe unë endesha i zbathur mbi një dysheme ku nga fundi ishte kalbur druri dhe bëja kujdes të mos shkelja mizat e dheut, jetëza të vogla edhe ato. Përballë një dritare, frëngji më saktë, rrafsh me dheun jashtë, që përveç hekurave të kryqëzuar, kishte edhe një thurimë tjetër teli të sertë. Vinte dritë e turbullt. Dhe befas dëgjova cicërima. Nuk kisha as letër, as stilolaps apo një copëz lapsi, nuk lejoheshin. Dhe nisa të them me vete:

Kaq bukur këndoi bilbili
te hekurat e frëngjisë sime,
sa dhe hekurat m'u bënë
degë të gjelbra qershie.
Dyshemeja u mbush plot me cicërima
dhe unë mëgjunjazi
si thërrime buke,
si thërrime jete
një nga një po i mblidhja.

Pra, isha gjallë. M'u duk sikur përftova çaste të mrekullueshme lirie, rishpika emocionin e krijimit, kështu m'u duk. Në ditët e tjera do të vërsulesha për poezi të tjera, i bëja me mend. Ndërrova robërinë. Homeri ekzistonte, nuk ishte trill... Ja, fantazma e tij në mur. Gjersa e pashë, domethënë unë isha.

Ç'ishte Lushnja për ju? Pas dënimit aty u rikthyet duke iu rikthyer edhe letërsisë dhe mbani kujtimet e para të lëvizjes për demokraci.

Më pëlqente ta quaja Lushnjën atëherë "Kryeqyteti i dhimbjes", sipas një vargu të poetit francez Pol Eluar. Pas burgut të tim eti dhe përndjekjeve, ai mori familjen dhe iku të fshihej në qytete më të mëdha. Në Durrës punoi si hamall porti, por e zbuluan dhe e hoqën, se porti ishte "zonë kufitare". Shtronte rrugët me kalldrëm dhe bënte shkallët e qytetit. Ato që të çojnë tek amfiteatri, ai i ka bërë. Një ditë e pa aty me çekan në dorë shoku i tij, student i Sorbonës, rektori i parë i universitetit shqiptar, ministri i Arsimit Kahreman Ylli. "Ç'bën aty?" - i tha. "E di partia", - iu përgjigj im atë. "Ne nuk mund të lëmë në rrugë "normalistët e Elbasanit", arsimtarët e talentuar", - kishte thënë ai dhe kështu im atë u emërua mësues në Lushnjë.

Duke qenë krijues dhe pasionant i teatrit, me shumë talent, u bë themelues i Estradës profesioniste të Lushnjës, aktor i saj, libretist etj. Lushnja na priti mjaft mirë. Na deshi. Krijuam miqësi të mira, shokë... Nisa të shkruaj, madje edhe të botoj qysh gjimnazist. Rrinim bashkë ashtu si me vëllezërit, me Fatbardh Rustemin e me poetin Faslli Haliti, që ishte edhe mësuesi ynë, me prozatorin Halil Jaçellari, me Sherif Balin, eseniniani ynë, por nuk mund të botonte dot nga shkaku i biografisë. Më donin shumë mësuesit e letërsisë, në 8-vjeçare Liri Kazazi që e kisha si shenjte dhe në gjimnaz Murat Nexha që ishte edhe sekretar partie. Kur ashpërsohej lufta e klasave, luftë civile në kohë paqeje, kam shkruar, kujtoheshin për ne që s'ishim me biografi të mirë politike. Ndodhi një pranverë e shkurtër shqiptare, që u dënua më pas si vitet e liberalizmit dhe unë pata fat, më çojnë të kryej studimet e larta në Shkodër, më emëruan mësues pastaj larg, shumë larg, në fshatrat e Kukësit, ku edhe arrestohem. Mbas shumë vjetësh burg kthehem në Lushnjë, pranë prindërve. Punoja në fabrikën e tullave, punëtor krahu me turne. Poeti Bujar Xhaferri më ndenji pranë si mik i hershëm. Njoha shokë të rinj që guxonin të rrinin me mua, si Ilir Prifti, Gazmend Kapllani, shkrimtari i ardhshëm me njohje edhe jashtë vendit tani, motrat Lloti, njëra mjeke dhe tjetra aktore, pianistja Mira Zyrakja, protagoniste në një film, skulptori Arian Bafa etj. I përmend jo vetëm për t'u treguar mirënjohjen, por për të thënë që edhe në diktaturë mund të thyhen ligjet dhe të krijohen miqësi të ndaluara. Mua më tërhiqnin fushëtirat, andej nga të internuarit, ku kisha edhe shokë të burgut, shkoja në këmbë, në Savër, te shkrimtari Lazër Radi dhe i biri i tij Jozefi, që shkruante. Më habiste një poezi e tij për Venecian, meraku se mbytej si një gondolë. Ç'ishte ky shqetësim kështu që nga internimet? Apo meraku për vetë jetën. Ra Muri i Berlinit. Ia ndiem rropamën, sikur të ishte shembur diku pranë. Po binte perandoria komuniste. Dhe diktaturat e saj... Ishim dëshmitarë të ngjarjeve të mëdha, epokale, botërore. Historia ishte te këmbët tona, po na bënte, po e bënim. Jam me të parët në Lushnjë që u përfshimë në protesta, në lëvizjen për "liri dhe demokraci", "Për një Shqipëri si e gjithë Europa", që ende vazhdojmë dhe bërtasim po kështu si gati 30 vjet më parë. Jemi themelues të opozitës në Lushnjë së bashku me, – po përmend vetëm njerëz të letrave, – Bujar Xhaferrin, Halil Jaçellarin, Shpend Sollakun, Gëzim Hajdarin. Merrnim pjesë

në mitingje, prisnim Azem Hajdarin, Sali Berishën, Gramoz Pashkon, Neritan Cekën etj.

Lushnja ziente. Protesta. Madje edhe funeralet e atyre që vrisnin në kufi se donin të arratiseshin, shndërroheshin në protesta. Fillova punë në gazetën e parë opozitare. Po guxonim. Kaosi tregoi se njerëzit donim lirinë, por s'dinin ta përdornin, kishim ide dhe dëshira. Nisën eksodet e mëdha. Si arbëreshët gjatë pushtimit otoman. Tek ne shekulli XX po përndiqej si në mesjetë.

Si e keni besuar lirinë, atë që do të vinte pas '90-ës? Se prej saj, besoj, ju mbijetuat, rezistuat, në burgje, në miniera…

Mbas '90-ës ne befas ishim të lirë për së jashtmi, për të mos qenë aq të lirë së brendshmi, në mendësi. Liria është përgjegjëse dhe atë nuk ta sjell kush, nuk vjen ashtu si stinët, ajo vetëkrijohet, së pari së brendshmi nga të gjithë bashkë. Liria është kulturë. Ne ende nuk jemi të lirë. Por më ngushëllon liria për të folur për lirinë.

Liri e shqetësuar... Nisët të vargëzoni si dikur në qeli për murin, hekurat, minjtë, bukën e thatë, policët që, siç e keni thënë, harruat përse ishit arrestuar, por nuk harruat përse ishit liruar. Po shkruanit, përveç artikujve të shumtë nëpër gazeta, edhe poezi, tregime, romane… Ç'kujton në këtë përpjekje, ç'ishin përsiatjet e një njeriu, poeti, nën këto "ndërrime kushtesh", a ndryshon edhe të shkruarit?

Jo. Për mua jo, në thelb natyrisht. Emocioni i krijimit është po ai, ndryshojnë dridhmat, frekuencat. Ndryshon sasia e krijimeve dramatikisht, merr thellësinë e nëntokës së burgut, madje edhe shter, kur je brenda ose merr gjerësinë e hapësirave, kur je jashtë dhe shter në tjetër mënyrë. Varet. Por emocioni i krijimit mbetet po ai, hyjnor. Patjetër që ndryshojnë fletorja e lagështitur e burgut me kompjuterin në studio, nuk të vezullon bajoneta e ushtarit përballë, por sasia e stilolapsave mbi një vazo porcelani, ndryshon shkëmbi i minierës nën tokë, ku dëgjon mërmërimën tënde të heshtur për të gjetur rima me skrivaninë, teksa dëgjon muzikë, rrugët e burgut në Spaç a Qafë Bari, ecejaket në Burrel me rrugët e Romës, Parisit, Uashingtonit, por të shkruarit është po ai, i njëjtë, po ajo përhumbje dhe dalldi, ajo vuajtje, grackë dhe ngazëllim. Kur shkruan në burg, fshehurazi dhe i uritur, do që të ndihesh i lirë, madje prandaj edhe shkruan, bashkohesh me të gjithë ata që shkruajnë kudo nëpër botë, shkruan se shpik liri tënden, të paktë si qiri i vobektë, gati të fiket, por përfton emocionin e krijuesit. Burgu ndërkaq s'ekziston më për ty, qoftë edhe një çast, ç'mrekulli të çmendesh, por nuk lejohet me ligj, dhe më të çmendur janë ata që të kanë dënuar e të mbajnë brenda telave me gjemba, ndërsa kur je jashtë i lirë dhe i ngopur, shkon vullnetarisht të mbyllesh për të shkruar, e do atë robëri se pas pak bëhesh krijuesi. Ajo që shkruhet në burg është e dobët si një tigër i pangrënë me vite, se edhe kohë s'ke pasur, s'ke kohë tënden fare, koha është e të tjerëve dhe jo vetëm që nuk do të botohet, por edhe duhet ta fshehësh, pasi ua ke treguar ca miqve më besnikë, që edhe ata sakrifikojnë për ato pak fleta të çjerra si nga kthetrat e atij tigrit të uritur, ndërsa jashtë, ah, jashtë ke kohë, madje edhe nge, tymos, pi kafe, shfleton enciklopedi, fjalorë, ngrihesh natën për të shkruar prapë etj., telefonon, smirëzinjtë ndoshta janë më të shumtë se policët në burg, por ti zgjedh vetë të bëhesh "i burgosuri" i krijimit tënd, kjo është mrekullia e njënjëshme, kur krijuesi është po ai, me fat ose pa fat, i gjallë ose fantazmë, i shpërblyer me çmime të republikës ose me plumba ballit a varje, siç ka ndodhur te ne. Prandaj, qoftë edhe një poezi e mirë e dalë nga burgu, apo një faqe romani, duhen nderuar, së pari akti i të shkruarit, atje ku ishte e ndaluar dhe e pamundur, kurse për fat kanë dalë dhjetëra vepra të vërteta nga burgjet dhe internimet, poezi e romane, drama, ditarë e letra, të cilave u duhet dhënë vendi i merituar në letërsinë e përbashkët, në skena e filma dhe në tekstet shkollore. Jo vlerësime vetëm pas vdekjes, se kjo na bind se paskëshim qenë ne, të vdekurit. Natyrisht, i di mirë edhe vështirësitë e sotme, që edhe tani ka diktaturë të varfërisë, moskohë, mosmundësira botimi, braktisje, klane, prapashpinëri, ndërhyrje të dëmshme, vjedhje, mosshpërblim total, por gjithsesi lavdi krijimit dhe Krijuesit. Prandaj është bota, prandaj është jeta.

"Kujtesa e ajrit", libri juaj i parë që botohet në Tiranë në vitin '93, nuk më duket i rastësishëm titulli, kujtesë dhe ajër. Pas një viti botuat "Hedh një kafkë te këmbët tuaja", ajo kafkë është burgu, ku përmblidhen poezitë e ferrit, të viteve '79-'89 të shekullit të kaluar që, siç ke treguar, një pjesë e mirë kishin mbijetuar vetëm në kujtesë, si letërsia në zanafillë, pastaj i shkrove, i fshehe, t'i fshehën edhe nën tokë. Vazhdojmë me librat e tjerë: "Mbjellja e vetëtimave" në Shkup; "Dyert e gjalla", "Kohë e vrarë në sy" në Prishtinë; "Thesaret e frikës" prapë në Tiranë dhe pastaj një përmbledhje monotematike, "Si shkohet në Kosovë", që del këtej dhe andej në Tiranë dhe e dyfishuar në Prishtinë. Një mori titujsh si porosi me vetëtima, sy, mbjellje, dyer, frikë, udhëtime... Pse?

Janë të kohëve të ndryshme, pjesë jete, i ka bërë koha. Mua më dhanë tani një si marramendth dhe "pse-të" e tyre kanë mërguar nga autori te lexuesi. Se edhe librat janë të tijtë. Ndoshta ai s'i di apo s'i di të gjithë, normale, ndoshta presin të takohen, mjafton



pritja edhe në s'u takofshin. Nëse duhet të them patjetër diçka për ta, po e nis nga fundi. Tashmë, siç ka një Itakë, sipas meje ka edhe një Kosovë të njeriut, që për ta arritur duhet të udhëtosh brenda vetes, ishte vendi yt dhe jo yti, ta kishin marrë pa ta marrë dot dhe në kundërshtim me Trojën që u mblodhën ushtritë e botës së hershme për ta rrënuar dhe ajo u bë më e fortë duke mos qenë, edhe për Kosovën u mblodhën ushtritë e botës sot dhe u bë e para luftë morale që ajo të çlirohej, të bëhej vetvetja. Kosova si metaforë. "Thesaret e frikës" – është fjala për frikën divine, nga vetja më shumë sesa nga tjetri, prej së cilës krijohen thesaret e virtyteve. Ka dyer të gjalla të rastësive që s'janë rastësi, ashtu siç ka edhe dyer që u vjen turp që janë dyer. "Kohë e vrarë në sy" është titulli i përgatitësit të antologjisë, e pranova. Kurse "Mbjellja e vetëtimave" mëton se drita ndonjëherë vjen e beftë, rrufeshëm, por ti mbill dritë. Kaq, se titujt e tjerë ju i shpjeguat fare mirë. Unë u jap rëndësi titujve, janë si adresat mbi zarfe, më duket se e ka thënës Shopenhauri këtë. Në fund të fundit, sa më shumë jetë në poezi, aq më shumë poezi në jetë...

Keni kaluar në prozë, keni shkruar tregime dhe romane, të rënda do të thosha, "Funerali i pafundmë", "Perëndia mbrapsht dhe e dashura", "Në kohën e britmës", madje edhe "Rrugët e ferrit" dhe Ferri i çarë", që ju i quani "burgologji", term i veçantë juaji, memuaristikë që lexohen si romane. Pse ky kalim, s'të nxinte më poezia?

Mbase. S'e di. Desha "me tregue, prandaj rrnojmë". Herë-herë kam ndjesinë sikur krijuesi shkruan mbi pergamenën e lëkurës së vet, nga brenda ka poezinë, nga jashtë prozën. Me "Funeralin e pafundmë" ç'ndolla? E kisha nisur në diktaturë, nga fundi i saj, dhe u botua si tregim. Në Çikago e përfundova si roman. Është përkthyer dhe botuar në Itali dhe Rumani, është pritur mjaft mirë nga kritika e këtyre vendeve, duke u konsideruar si roman postkubist e postkafkian kundër totalitarizmit kudo e në çdo kohë. Kur shkruaja romanin "Perëndia mbrapsht dhe e dashura", këtu është ai personazhi i fantaksur që vendos të ecë mbrapsht për sfidë, pasi ka hedhur në gjyq në Hagë gjithë atdheun etj., kam vuajtur edhe fizikisht. Është përkthyer edhe ky në italisht dhe ka pasur artikuj edhe në "Corriere della sera". Ndërkaq vazhdova me një tjetër roman, "Në kohën e britmës", më i komplikuar si intrigë, ku është edhe eksodi, tragjedia e Otrantos, pak realize magjik etj., por ka edhe diçka tjetër si dukuri e tanishme, si ta them, ja, që prej të persekutuarve pranohen dëshirat e tyre, ëndrrat, vizionet, por për paradoks jo ata vetë, pra idetë pa ideatorët, persekutorët e tyre vazhdimisht i shmangin ata, i nëpërkëmbin, i braktisin, për t'i bërë të paqenë, pa guxuar t'i vrasin. Nëse tregova ca si shumë, thjesht desha të thosha se në konkurset tona letrare këto romane janë shmangur. Në fakt, doja të thosha se letërsia që erdhi nga burgjet, më duket se nuk mirëpritet, harrohet qëllimshëm, nuk duan të shqetësohen prej saj. Për të hapur ndërkaq atë që s'po hapej, "Dosjen e diktaturës", letërsia jonë e nisi e para. I jam bashkuar këtij akti madhor, kam botuar dy burgologjitë, "Rrugët e ferrit" dhe "Ferri i çarë", kampet e Spaçit dhe të Qafë Barit, antijetën e të burgosurve, dhunën, revoltën, qëndresën, përpjekjet mbinjerëzore për të mbetur njeri. U mora nja 10 vjet me burgologjitë. Kur i shkruaja, ime shoqe u bë merak, s'isha mirë, zbehesha shpesh, kisha makthe. Isha vetëburgosur sërish...

Të shkruarit tuaj është poetik, mendoj se poezia të ka shpëtuar, siç e thua edhe vetë, nga shumë mistere, sekrete, që i "zbulojnë" ndjesitë, ajo çfarë ke përjetuar... Po hermetizmi, thënë ndryshe, përse të është dashur? Keni pasur ndikime, referenca, çfarë e shoqëronte formimin tuaj si letrar?

Keni të drejtë. Hermetizëm, jo si ai europian që jo s'e fsheh, por do që të nënkuptohet e paarritshmja. Më i vrazhdë është yni, ekzistencial, i mbijetesës. Absolutisht, ndikimet janë të pashmangshme, madje me to krijohesh, por edhe zhbëhesh. E thotë mjaft bukur Oscar Wilde: "Bëj vetveten se vendet e tjera janë të zëna." Si? S'ta mëson askush. Duhet ta zbulosh vetë. Ky është një proces i gjatë, shpesh i pakuptueshëm dhe i patregueshëm. Më vështirë e ka ta shpjegojë ai që pyetet dhe më lehtë ai që pyet. Di të them që në fëmijërinë time im atë na tregonte shkëlqyer përrallat, pastaj na dha adhurimin për Naimin dhe Fishtën. Për estradën ku ai punonte. Më magjepsën disa ikona që kishin mbetur në rrënojat e kishës së Golemit në Lushnjë, gjatë shembjes barbare të kishave dhe xhamive. I solla në shtëpi...

Gjimnazist lexoja dhe mbushesha me poezi me Kadarenë, Fatos Arapin, Dritëro Agollin dhe isha i magjepsur nga Esenini, Uitmani dhe Kahjami i Nolit, libra gjysmë të ndaluar, aq gjenim, por edhe nga Majakovskij futurist. Poezitë e Realizmit Socialist më dukeshin si aksionet dhe punët vullnetare që ishin me detyrim e britma. Kishim në shtëpi "Visaret e Kombit". Shekspiri i Nolit ishte si një kështjellë gjithë mister dhe frikë që më tërhiqte. Desha Tolstoin, Gollsuorthin... "Shvejkun" ia lexoja me zë tim eti dhe qeshnim me lot. Student u mora si një student me Homerin, Danten, Lorkën, Eluarin... Lexova fshehurazi poezi nga Kosova, u ndikova nga Shkreli dhe Podrimja, do i bëja miq në epokën tjetër... Edhe Kanunin e Lekë Dukagjinit... Dëgjoja pa u ngopur këngëtarin Demis Roussos dhe *Simfoninë e Fatit*, Bethoven... "Don Kishoti" i Petro Zhejit më ndolli sa ai i Nolit dhe Petroja më pataksi për mirë me Asturiasin. Pashë disa riprodhime të Pikasos

në një revistë sovjetike dhe mbeta pa gjumë... Edhe nga këpucët e Van Gogut... Më vonë u lidha me Borgesin dhe aty mbeta. Një roman të Dostojevskit kur punoja mësues në fshat arrita ta lexoj nën një llambë me vajguri, fshehurazi, që të mos më shikonin ata me të cilët isha në dhomë. Nja dy prej tyre ua di pseudonimet tani, ishin informatorë. Në burg lexova të plotë Sofokliun, të shtatë tragjeditë e tij, përkthim burgu nga miku im poet Kujtim Aliaj, shkruar me dorë në disa fletore dhe s'desha gjë tjetër, aq sa m'u duk se letërsia më vonë ishte prishur, gjë që m'u përforcua me Eskilin, e lexova mbas burgut, ishte botuar ndërkaq dhe më priste. Edhe Markezi. Më dhuruan Kafkën, ah, sa vonë! Se ç'gjeta, atë që kishte humbur nëpër shekuj nga tragjedianët e mëdhenj, por ndryshe. Më argëtoi trishtueshëm *Uliksi* i James Joyce-t. Ah, Anton Pashku i gjorë... Dhe dëgjoja si një i ri këngët e Michael Jackson-it. Shallamovi me tregimet po aq dërrmuese sa "Arqipelagu Gulag" i Sollzhenicit, në mos më shumë. U jam rikthyer Ernest Koliqit dhe Mitrush Kutelit, janë dy themeltarë të pazëvendësueshëm. Shtoj këtu Martin Camajn, dukuria më e arrirë e letërsisë së diasporës. "Darka e Fundit" e Da Vinci-t dhe "Cappella Sistina" e Michelngelo-s më shastisën. Duhej të vinin rojat e muzeut për të nxjerrë, se do të mbyllej. Po kështu edhe Picasso origjinal, Salvador Dali, Marc Chagall, Egon Schiele, Henry Moore... Shtatë tragjeditë e Et'hem Haxhaidemit dhe shtatë komeditë e Hekuran Zhitit them se janë një pasuri e madhe e skenës shqiptare dhe bashkohem me kritikën ndaj tyre. Vazhdoj ta kërkoj letërsinë që erdhi nga burgjet dhe internimet. Është pjesë panteonike e letërsisë shqipe. Mund të kenë ndikuar tek unë edhe të tjera që s'e kam kuptuar si. Vuajtja duhet të jetë më e madhja. Së fundmi, do doja të thosha se kam qenë lexues profesionist, i përditshëm, nuk jam më. Më kanë thënë se edhe unë kam ndikuar, madje edhe jam marrë, jo vetëm nga më të rinjtë. Mbase. Po kjo "mbase" ka rëndësi…

Vepra juaj vazhdon pafund të jetë mbi dhimbjen, shpirtin... A ka pasur te ju një kërkim mbi thelbin e poetit, shkrimtarit?

Thelbi nuk kërkohet. Ai është. Vetë krijuesi është thelb.

Dua të krijoj një raport reflektimi për gjeneratën: babai, dramaturgu Hekuran Zhiti, ju dhe yt bir Atjoni, engjëllori, etër dhe bij, ku ju qëndroni në mes tyre, herë shkruani për paraardhësin dhe nuk pushon malli për pasardhësin që është në Qiell. Një Shqipëri më të mirë sesa e etërve, keni thënë se është shprehur Atjoni.

Në emër të Atit, Birit dhe Shpirtit të Shenjtë! Unë lutem. Ndiej misionin... Prandaj vazhdoj të jetoj. Me rrugën e së shkuarës në errësirë dhe të së ardhmes po ashtu. I rënë në fundbotë, nuk flas dot për këtë... Teksa doja të tregoja etërit, por edhe letërsinë e tyre si pjesë e kujtesës, të cilët bijtë duhet ta dinë, ta njohin, ta vazhdojnë, ta kundërshtojnë, sepse do t'i ndihmojë për një Shqipëri më të mirë. Sidomos shpirtërisht... Besoj se ajo ç'kam shkruar unë, nuk ngjan me letërsinë e tim eti, është tjetër, ndryshe do ta kisha lënë me kohë. Libri i tim biri, siç e thotë edhe titulli "Për atë që dua(m)", prapë është tjetër gjë, përmbledh ese dhe përsiatjet e një studenti, ëndrrën rinore, të ndërprerë. Ai nuk do ta besonte dhe as do ta pranonte një libër të tij qysh 19 vjeç. E solli fati. Gjenerata e tij, ata që i do dhe e duan pa ndërprerje, pranojnë se kanë marrë prej tij ca porosi të çmuara dhe ngjyra gëzimi të moshës, pikturat, kanë marrë guximin dhe dashurinë, dhe një buzëqeshje kryevepër, një mrekulli që gjithmonë vjen nga kudo, e di ajo si dhe qysh. Ne jemi një trini ku unë shungulloj në mes si një pemë në shtrëngatë mes vetëtimave. Dritën e tyre desha të sjell dhe qëndresën mbi tokë.

Ka prehje, ka qetësi për ju?

Do të ketë në të përtejmen...

Tiranë, Prishtinë, Shkup – këto janë qendrat ku jeni botuar. Sipas jush, çfarë nuk është arritur ende mes tyre?

Libri që na bashkon, që nuk po na bashkon si duhet... Kur them "libri", kuptoj shumë më shumë...

Për cilin lexues mendon shkrimtari?

Atë që është vetvetja.

SAMANTA SCHWEBLIN
IM VËLLA UALTER

Im vëlla, Ualteri, ka rënë në depresion. Unë me time shoqe shkojmë dhe e shohim përnatë, kur kthehemi nga puna. Blejmë diçka për të ngrënë – atij i pëlqen shumë pula me patate të skuqura, – dhe i biem ziles së derës, aty rreth orës nëntë. Ai ngrihet menjëherë dhe pyet: "Kush është…?" "Ne!" - i përgjigjet ime shoqe. "Ah…" - thotë ai dhe na hap derën.

Me dhjetëra persona e marrin përditë në telefon për ta pyetur se si është. Ai e ngre receptorin me mundim, sikur të peshuakësh një ton, dhe thotë:

- Po?

Dhe njerëzit i flasin sikur im vëlla të ushqehej me budallallëqe. Kur e pyes se kush është, apo çfarë duan, ai nuk më përgjigjet dot. As që i intereson hiç. Ka rënë në një depresion aq të thellë, saqë nuk bezdiset fare që ne jemi aty, ngaqë është njësoj si të mos ishim.

Ndonjë të shtunë, ime ëmë dhe teze Klarisa e marrin me vete në sallonet e festave të moshatarëve dhe Ualteri e kalon kohën duke qëndruar ulur nëpër datëlindje dyzetvjeçaresh, festa beqarie dhe të sapomartuarish. Teze Klarisa thotë se, sa më thellë zhytet në depresion Ualteri, aq më të lumtur janë njerëzit që e rrethojnë. Ç'është e vërteta, ajo që duhet pranuar, është fakti se, qysh kur Ualteri ka rënë në depresion, gjërat në familje po shkojnë përherë e më mirë. Ime motër, më në fund, martohet me Galdosin dhe në dasmë, mes një grupi njerëzish, të cilët pinë shampanjë dhe qeshin me lot, tek tryeza e tim vëllai, ime ëmë njeh zotin Kito, me të cilin tani fle përnatë. Zoti Kito ka kancer, por është një burrë tepër energjik. Mandej, na del se është edhe pronari i një kompanie të madhe drithërash dhe mik fëmijërie i teze Klarisës. Galdosi dhe ime motër blejnë një fermë larg qytetit dhe nisim zakonin t'i kalojmë atje fundjavat. Të shtunave në mëngjes, ime shoqe dhe unë shkojmë e marrim Ualterin dhe para mesditës, të gjithë jemi të mbledhur në fermë, duke pritur të piqet mishi në skarë, me një gotë verë në dorë dhe me atë lumturinë e pamasë që të japin ditët me diell në ajër të pastër. Munguam vetëm një fundjavë, pasi Ualterin e kishte zënë gripi dhe nuk pranoi të hipte në makinë. Unë mendova se duhet t'i lajmëroja të tjerët që Ualteri nuk do të shkonte, kështu që filluan të ndërthureshin telefonatat nëpër celularë dhe aty rreth orës kur Galdosi nis ta shërbejë mishin e skarës, që të gjithë e kishin anuluar shkuarjen në fermë.

Tani, teze Klarisa është lidhur me mbikëqyrësin e fermës dhe që të gjithë në familje jemi çift, përveç Ualterit sigurisht. Pranë skarës është një karrige, të cilën ai e zgjodhi dhe u ul qysh ditën e parë që e çuam në fermë dhe nuk çohet më prej saj. Gjithmonë përpiqemi t'i qëndrojmë pranë, për t'i ngritur moralin ose për t'i bërë shoqëri. Qeshim shumë dhe përgëzojmë Kiton, ngaqë kanceri i tij thuajse është kuruar, përgëzojmë Galdosin për mbarëvajtjen e fermës, përgëzojmë gjithashtu dhe time ëmë, ngaqë thjesht e adhurojmë. I dëgjojmë me buzagaz time motër dhe time shoqe, të cilat shkojnë për mrekulli me njëra-tjetrën, dhe komentet e tyre mbi aktualitetin na bëjnë të qeshim me lot.

Por Ualteri vazhdon në depresion. Ka një çehre të tmerrshme, përherë e më të trishtë. Galdosi sjell në fermë një mjek të njohur fshati, i cili interesohet menjëherë për rastin e Ualterit. Mjeku është një tip i shkëlqyer dhe nis të vijë çdo fundjavë. Nuk na merr asnjë monedhë; gjithashtu vjen edhe gruaja e tij, për të biseduar me time shoqe dhe time motër. Kësisoj, një ditë, teksa mjeku, Kitoja dhe Galdosi bisedojnë me ëndje përreth Ualterit, duke pirë duhan e duke treguar budallallëqe për ta argëtuar pak, përfundojnë duke pasur një bisedë të jashtëzakonshme biznesi dhe së bashku nisin një sipërmarrje të re drithërash, nën emrin e firmës së Kitos, por në fermën e Galdosit dhe me një recetë më të shëndetshme, të propozuar nga mjeku. Edhe unë i bashkohem projektit dhe më duhet të qëndroj në fermë gati çdo ditë, kështu që, kur ime shoqe ngelet shtatzënë, shpërngulemi në fermë dhe e marrim me vete edhe Ualterin, i cili praktikisht nuk shpreh asnjë mendim për këto ndryshime. Na qetëson fakti që ai është këtu me ne, që e shohim të ulur në karrigen e vet, që e dimë se e kemi pranë.

Drithërat e reja shiten mjaft mirë dhe ferma mbushet plot me punëtorë dhe tregtarë grosistë. Njerëzit janë të dashur. Duket se besojnë symbyllazi te projekti i ri dhe mbizotëron një energji optimiste, e cila vazhdon ta ketë kulmin e shkëlqimit të saj gjatë fundjavave, përherë e më të populluara, kur mishi i skarës së Galdosit fillon të marrë ngjyrën e pjekjes dhe të gjithë, me gotat në dorë, presim me padurim. Tani jemi aq shumë, saqë nuk ka asnjë sekondë që Ualteri të ngelet vetëm; gjithmonë është dikush që e merr përgjegjësinë e të qenit pranë tij, që i flet gëzueshëm, i rrëfen lajmet e mira, i tregon se sa i lumtur mund të jetë njeriu.

Ndërmarrja rritet. Kanceri i Kitos zhduket krejt dhe im bir mbush dy vjeç. Kur ia lë në krahë Ualterit, im bir buzëqesh, duartroket dhe thotë: "Jam i lumtur, jam shumë i lumtur." Teze Klarisa me mbikëqyrësin bëjnë një udhëtim nëpër gjithë Europën; kur kthehen, shkojnë në kazino bashkë me time motër dhe Galdosin; me paratë që fitojnë, krijojnë një firmë dhe blejnë markat e drithërave të konkurrencës. Për Vit të Ri, ndërmarrja fton gati gjithë fshatin ku është ferma – pasi, praktikisht, të gjithë banorët punojnë në fermë, – grosistët, miqtë dhe fqinjët. Skara organizohet në darkë. Një bandë muzikore luan atë muzikën xhaz të viteve tridhjetë, e cila të bën të kërcesh si të ishe zezak. Fëmijët luajnë duke i pleksur zbukurimet e Vitit të Ri nëpër karrige e tryeza.

U bë kohë që unë, herë pas here, e marr veças tim vëlla, ose kërkoj një çast që të jemi të qetë dhe e pyes se çfarë ka. Ai qëndron i heshtur, por automatikisht m'i shmang sytë. Është e vështirë ta pyes tani, pasi ora është dymbëdhjetë fiks dhe pasi tokim gotat, hedhim fishekzjarrë, nga ato që e ndriçojnë tërë qiellin, dhe njerëzit brohorasin e duartrokasin në çdo shpërthim. Atëherë, diç ndiej: gjithçka më duket më e butë dhe më gri, dhe nuk resht dot së menduari se çfarë është ajo që po ndodh me tim vëlla, ajo që duket aq e tmerrshme.

Përktheu nga origjinali Erion Karabolli
Marrë nga libri me tregime "Zogj në gojë", së shpejti nga Onufri

LIBRI JO I ZAKONSHËM I SULIT DHE SULJOTËVE

Nga Aurel Plasari

Faik Konica, që lidhur me burimet albanologjike zotëronte informacion maksimal për kohën e vet, ka pasur për këtë libër një njoftim të tërthortë, pa ia dalë të identifikonte botimin dhe/ ose botimet. Më shqip: pa e futur dot në dorë. Tek "Albania" e vitit 1904, nr. 11 dhe 12, njoftoi një përmbledhje shqip të librit në fjalë prej një përmbledhjeje anglisht nga Thomas de Quincey, shqiptar të cilin Faiku e admironte për romanin "Rrëfime të një ngrënësi anglez opiumi". Botimin origjinal as De Quincey nuk e kishte pasur për duarsh, por e kishte shuar kureshtjen e një libri për Sulin dhe suljotët të botuar në greqishte më 1815 në Venedik nëpërmjet një përkthimi italisht të vitit 1819.

Konica e kishte mësuar shënimin e anglezit De Quincey nga vëll. X i veprave të shkrimtarit, *Complete Works*, bot. 1862. Në të vërtetë, De Quincey ka qenë joshur nga historia e Sulit dhe e suljotëve tre dhjetëvjetësha më herët, kur në revistën historike me të cilën bashkëpunonte, *Blackwood's Edinburgh Magazine*, vëll. XXIII i muajve janar-shkurt 1833, botohej një shkurtore e historisë së revolucionit grek nga Thomas Gordon (f. 476-502). Ishte fjala për veprën madhore të sapodalë asokohe në publik *History of the Greek Revolution*, London 1832. Edhe pse vepra përmbante mjaft njoftime për arbërorët e Greqisë si banorë të Atikës, Argolit, Beotisë, Fokisë, ishujve Hidër, Specie, Salaminë, Andros dhe të një numri fshatrash në Arkadi, në Akajë dhe në Meseni etj., përfshi edhe doket e zakonet e tyre, si dhe për historinë kontroverse të Ali pashë Tepelenës, De Quincey ishte i mendimit që në të meritonin më shumë vend me historinë e tyre Suli dhe suljotët. Prandaj ai i shtonte aty në një shënim të gjatë përfund faqeve 485-492 duke e sqaruar kështu burimin e përdorur: "Ne e nxorëm atë (për ç'u përket fakteve) nga një vepër e vogël e hartuar në origjinal nga një shqiptar në greqishte të re dhe të botuar në Venedik më 1815. Kjo vepër qe përkthyer menjëherë në italisht, nga Gherardini, një oficer italian i Milanit. Dhjetë vjet më vonë u riprodhua edhe në version anglisht, me disa pak shkurtime, por në Angli duket të mos ketë tërhequr vëmendjen e publikut dhe, me gjasë, është harruar."

Botimi greqisht i vitit 1815 në Venedik, me titullin që në shqip do të përkthehej "Histori e Sulit dhe e Pargës që përmbledh kronologjinë dhe luftërat e tyre heroike, veçanërisht ato të suljotëve, me Ali pashën, prijësin e Greqisë", ruhet në koleksionet albanologjike të Bibliotekës Kombëtare, Tiranë, me ardhje prej fondit "Lumo Skëndo". Në këtë botim autori e ka fshehur emrin duke nënshkruar me pseudonimin "Byk Pso Psxī La, Aōka" dhe kuptohet se përse: ngaqë libri i bënte sfidë turkokracisë në atdheun e pushtuar. Letra përkushtuese me të cilën hapet libri, është nënshkruar "Stefanos Anagjirasios". Po në të njëjtin koleksion ndodhet edhe botimi në italisht, ai që pati njohur dhe përmendur Thomas de Quincey, me titull: *Storia di Suli e di Parga, contenente la loro cronologia, le loro guerre e specialmente quelle de' Sulioti con Ali-Bascià, principe della Grecia, scrita in Greco-volgare da Byk Pso Psxī La Aōka e tradotta in lingua italiana dal ragioniere Carlo Gherardini Milanese Membro corrispondente dell' Accademia Jonia*, Milano 1819.

Përkthyesi italian Gherardini, që kishte shërbyer në Korfuz dhe e kishte njohur në vend situatën arbërore të Epirit, ka treguar në parathënien e përkthimit italisht që ishte takuar edhe me Ali pashë Tepelenën, tek i cili e paraqiti konsulli Pouqueville.

I dhënë sidomos mbas fakteve luftarake, Gherardini kuptohet të jetë joshur nga historia e qëndresës dhe e luftërave të suljotëve për të mbrojtur lirinë e tyre nga dhuna e pashallarëve. Ngaqë interesohej për atë histori, atij i ra në dorë libri i botuar në Venedik më 1815, që do ta përkthente dhe botonte në italisht më 1819. Falë këtij përkthyesi të mirinformuar mësohet fakti i rëndësishëm: vepra që ai ka përkthyer është shkruar *da un ufficiale albanese*, pra nga një ushtarak shqiptar. Çudi nuk është që autorin anonim ta ketë zbuluar nëpërmjet Pouqueville-it, i cili në ato mjedise kishte rrjetin e vet – të paguar – të informacionit. Thomas de Quincey prandaj e ka vënë në dukje këtë fakt në shënimin e vet historik: *a little work originally composed by an Albanian in modern Greek*. Dhe e ka përsëritur mandej disa herësh: *the Albanian author*, *the Albanian author*.

Autori i vërtetë i veprës mësohet në një botim më të vonë të saj, të vitit 1857 në Athinë, i cili mund të quhet edhe përpunimi i saj përfundimtar. Ka tanimë titullin *Histori e Sulit dhe e Pargës,* që përmban kronologjinë e tyre, betejat kundër osmanëve, kryesisht ato me *Ali pashën, satrapin e Epirit* (Ιστορία του Σουλλίου και Πάργας περιέχουσα Την χρονολογίαν αυτών, τας προς τους Οθωμανούς μάχας, κυρίως δε τας προς τον Αλή Πασά Σατράπην της Ηπείρου, Τύποις Φ. Καραμπίνη και Κ. Βάφα, *1857). Ishte çliruar Greqia dhe autori e ka nënshkruar këtë botim me emrin* Kristofor Perrevó.

Vdekja e Marko Boçarit" nga Ludovico Lipparini, Civico Museo Sartorio, Trieste (Itali)

Ky qe emri luftarak dhe politik i birit të një familjeje nga të arbërorëve të Thesalisë, që në të vërtetë quhej Krisaf Haxhivasili (1773-1863).

Arvaniti Kristofor Perrevó duhet të ketë qenë i lidhur qysh herët, njëzetecavjeçar, me Sulin dhe i përfshirë në qëndresën e suljotëve – si dhe të parganjotëve – ndaj sulmeve të mercenarëve të Ali pashë Tepelenës. Qe detyruar të mërgonte për të studiuar në Bukuresht dhe mandej në Vjenë. Aty, në Vjenë, ra në takim me Riga Fereon, famëmadhin ideolog të çlirimit të popujve ballkanikë nga turkokracia. Më 1817 udhëtoi në Rusi, për të rënë në marrëveshje me Eterinë Filike ose "Shoqatën e Miqve"; ajo përgatiste kryengritjen çlirimtare të Greqisë. Vetë ka treguar se si në Shën Petersburg i paraqiti carit Aleksandër projektin revolucionar për çlirimin e Greqisë. Cari nuk e përfilli. Nëpër Europë, mbas kësaj, i përndjekur nga polici të disa vendeve, i arrestuar, i burgosur, qe shtrënguar të bënte jetë konspiratori.

U kthye në Greqi jo vetëm si njëri ndër organizatorët e kryengritjes çlirimtare, por edhe si luftëtar dhe komandant luftëtarësh. Këtë veprimtari e ka dëshmuar në një tjetër vepër të vetën, *Kujtime të luftës* (Απομνημονεύματα πολεμικά), që përfshijnë vitet 1820-1829, bot. Athinë 1836. Është vepër me vlerë burimore origjinale edhe kjo, posa që nëpër të përshkruhen me përimtí ngjarje të luftës për çlirimin e Greqisë nga ana e një pjesëmarrësi në to. Sulit luftëtari i është kthyer përsëri, sepse më 1821 suljotët qenë kthyer nga mërgimi në Korfuz. Ata burra qenë kthyer për t'i ardhur në ndihmë në momentet e tij kritike Ali pashës, – përndjekësit dhe masakruesit të tyre, – tani kur sulltani e kishte shpallur fermanli. Luftonin, pra, tani pro Ali pashës kundër ushtrisë së sulltanit. Ndër komandantët e tyre rezulton edhe vetë Kristofor Perrevoi, përkrah me të tjerë arvanitë në zë nga Boçarët, Zervat, Xhavellat, Kuconikat etj., siç e ka treguar.

Me interes fakti që Perrevoi e ka dëshmuar në *Kujtimet e luftës*: vetë Aleksandër Ipsilanti, kryetar i Eterisë, e kishte miratuar këtë ndihmë të suljotëve për Ali pashën si pjesë e përgatitjes së kryengritjes greke; ajo pikërisht atë vit (1821) shpërthente në Peloponez për t'u hapur edhe në të tjera krahina të Greqisë.

Arvaniti Perrevó qe pjesëmarrës në një numër të madh betejash të revolucionit grek, por ato nuk ka vend këtu për t'ia numëruar. Më 1823 ndodhej në Misolongjin historik dhe po atë vit merrte pjesë në "Asamblenë Kombëtare", e cila e emëroi ministër të Luftës. Mbas themelimit të Mbretërisë së Greqisë për meritat e tij luftarake u gradua kolonel, mandej gjeneral. Kishte marrë pjesë në Asamblenë III Kombëtare të Argosit, mandej në Asamblenë IV etj., gjithnjë si përfaqësues i Thesalisë.

Në të tilla rrethana, në Asamblenë Kombëtare Kushtetuese të 1844-s, libri *Histori e Sulit dhe e Pargës* i shërbeu për të mbrojtur me fakte historike kontributin e popullsive "heteroktone" – kështu emërtoheshin popullsitë etnikisht jogreke – të Epirit, Thesalisë dhe Maqedonisë për çlirimin e Greqisë.

Për ç'i takon librit në fjalë, Émile Legrand në veprën e vet themelore *Bibliographie Albanaise* (1912) ka saktësuar që botimi i vitit 1815 nuk qenkësh veçse i dyti botim i tiji, ndërsa një botim i tij i parë ishte kryer në Paris më 1803. Qysh në kohën e vet bibliografi i cilësonte të rralla të dyja botimet. Për atë të 1803-shit: "botim i parë dhe fort-i-rrallë" (nr. 132). Për atë të 1815-s: "botimi i një rallësie të madhe" (nr. 135). Fatmirësisht, botimi i parë "fort-i-rrallë" i vitit 1803 sot mund të preket me dorë në disa biblioteka të Europës, si në Bibliotekën Kombëtare të Vjenës (dikur *Kaiserlich und Königliche Hofbibliothek*), në bibliotekën e Universitetit të Kretës etj. Nga ballafaqimi i dy botimeve, të 1803-shit dhe 1818-s, kuptohet që i pari ka përbërë vetëm një vëllim, ndërsa i dyti është botim i plotësuar dyvëllimësh.

Edhe një tjetër fakt me interes rezulton nga ballafaqimi i tyre. Në f. 9-10 të botimit të parë tekstin e paraprin një poezi me titull *Elegji e shenjtë gjashtëvargëshe kushtuar maleve të Sulit* e nënshkruar "Andronikos Olynthios Toronaeos". Nga botimi II kuptohet që ky qenkësh pseudonimi i Andrea Idromenos, klerik nga Parga (Ἀνδρέας ιερεύς Ὑδρωμένος ὁ Ὑπαργείος), i ati i Arsen Idromenos të zhvendosur nga Parga në Shkodër dhe gjyshi i të mirënjohurit tonë Kolë Idromeno.

Botimi i 1803-shit është befasues nëse mbahet në sy që qëndresa përfundimtare e suljotëve për të mbrojtur liritë e tyre nga ushtritë e Ali pashës u arrit të shtypej pikërisht në atë ndërkohë.

Përgjatë vitesh suljotëve u qe dashur të përballonin ushtritë e pashallarëve paraardhës të Aliut në plot nëntë beteja historike, nga të cilat kishin dalë fitimtarë. Në kohën e sundimit të Ali pashës, si i kishin mundur në dy beteja ushtritë e tij, beteja e tyre e fundit me të kishte filluar më 2 tetor 1800, – data që jep autori i librit, – për të përfunduar më 2 korrik 1802. Me mesin e vitit 1802 përfundon edhe pjesa e parë e botimit të Parisit të vitit 1803 për ç'i takon Sulit. Pra, sado të duket e pabesueshme, qenkësh fjala për një libër të shkruar e të botuar flakë-për-flakë me ngjarjet tragjike të Sulit dhe të suljotëve. Sikurse në pjesën e dytë të librit të botimit të Venedikut 1815 shtjellohet edhe më, qëndresa e suljotëve nuk qe shtypur plotësisht. Ajo vijoi deri në fund të vitit 1803: në dhjetor të atij viti Ali pasha ra në ujdi me suljotët duke i lejuar të merrnin kishin e ç'nuk kishin dhe të mërgonin për në ishujt e Jonit. Po atë muaj u regjistruan akti heroik i murgut Samuil, që hodhi në erë veten së toku me magazen e barotit, si dhe heroizmi i grave suljote që, duke vallëzuar e këndur, u hodhën në greminë për të mos i rënë në dorë turkut. Në libër autori i krahason luftëtarët suljotë me spartanët e antikitetit, ndërsa heroin Foto Xhavella e quan "një Leonidhë i dytë".

Përpos historisë së qëndresës dhe betejave të suljotëve, autori ka ndërtuar një minihistori gjeografike dhe etnografike të "shtetit të vogël". Ajo ka vlerën e rrallë që të jetë mbështetur në dëshmi të vjela prej tij në vend. Burimi i tyre janë të dhënat prej pleqve të Sulit, në një ndërkohë ndoshta të papërcaktuar sak, por gjithsesi kohë më parë se Suli të prishej. Prej pleqve të Sulit autori ka parashtruar përfundimin e prejardhjes së suljotëve nga një zhvendosje, me disa ndërkohë, e banorëve të Gardhiqit, të cilët i parapëlqyen ato male dhe pyje si vende më të qeta e më të sigurta, pra më të lira.

Edhe Panajot Aravantinoi (për vete çam nga Parga) te vepra madhore *Kronografi e Epirit* (1854) i ka bërë suljotët me prejardhje arbërore, që flasin shqip, dhe të vajtur në Sul nga Gardhiqi (v. II, f. 156). Mirëpo edhe ky po në librin e Perrevoit është mbështetur, siç e ka përmendur vetë.

Një njoftim i tillë e bëri Konicën të pohonte që suljotët qenë "lebër të thjeshtë", duke qenë që Kardhiqi ndodhet "në mes të Labërisë". Për të "labësia" e



ΙΣΤΟΡΙΑ ΣΥΝΤΟΜΟΣ
ΤΟΥ ΣΟΥΛΙΟΥ
ΚΑΙ ΠΑΡΓΑΣ

Περιέχησα τὴν Ἀρχαιότητα αὐτῶν, καὶ Ἡρωϊκὸς μετὰ τῶν Τουρκῶν Πολέμους, καὶ μάλιστα τοὺς, τοῦ Σουλίου μετὰ τοῦ Ἀλῆ Πασιᾶ κατόικου τῶν Ἰωαννίνων, καὶ ἡγεμόνος τῆς Γραικίας, καὶ Μακεδονίας.

Τόμος Πρῶτος.

Ἐν ΠΑΡΙΣΣΙΟΙΣ. κατὰ τὸ 1803.

Botimi i parë i veprës *Histori e Sulit dhe e Pargës*, Paris 1803



STORIA
DI SULI E DI PARGA
CONTENENTE
La loro cronologia, le loro guerre
e specialmente quelle de' Suliotti
con Ali-Vascià, Principe della Grecia
SCRITTA IN GRECO-VOLGARE
DA
ΒΥΚ ΨΟ ΦΞΗ ΛΑ, ΑΩΚΑ
E tradotta in lingua italiana
DAL RAGIONIERE
CARLO GHERARDINI MILANESE
Membro corrispondente dell' Accademia Jonia.

1819.

Milano. Dalla Tipografia di Giuseppe Borsani
Corso di Porta Orientale N. 636.

Botimi italisht i veprës *Histori e Sulit dhe e Pargës*, Milano 1819

suljotëve konfirmohej edhe nga fjalorthi shqip-greqisht i Marko Boçarit, që Konica e kishte nxjerrë për ta botuar nga Biblioteka Nacionale e Parisit. Konica i ka rënë shkurt duke mos ditur, ose duke mos dashur të dinte, që në këtë mes nuk hyn në vështrim vetëm Gardhiqi – më sak Kardhiqi – i Labërisë. Me të njëjtin emër ka disa fshatra në Epir, Arkadi dhe krahina të tjera të Greqisë. Fshatra që duket të lidhen drejtpërsëdrejti me prejardhjen arbërore të suljotëve janë, për shembull: 1) Gardhiqi në Thesproti, që quhet edhe pjesë e Sulit, si dhe 2) Gardhiqi po në Thesproti, që mbahet pjesë e Filatit. Nuk mund të mos vihet re që Aravantinoi i përmendur ka pas saktësuar: "nga fshati Gardhiq i Paramithisë" (po aty).

Edhe për prejardhjen e emrit të Sulit autori i librit ka dhënë një variant vendës duke kundërshtuar hipotezat klasike të do autorëve të huaj, të cilët ia lidhnin emrin me *Selin* që ka përmendur Homeri ose me *Solion* që ndeshet tek Tukididi. Për t'i hedhur poshtë mëtime të tilla Perrevoi ka dhënë argumente dërrmuese gjeografike si njohës i mirinformuar i terrenit, sidomos në një shtojcë të botimit të dytë ku ka parashtruar një apologji të tërë kundër "një anglezi".

Ai ka përshkruar më tej përbërjen e katër fshatrave të mirëfilltë të Sulit, si dhe të gjashtë fshatrave të tjerë që i ka quajtur "të kolonizuar" prej suljotësh. I ka përshkruar fshatrat duke i numëruar familjet emër më emër, nga më të hershmet te më të rejat, madje duke njoftuar edhe prejardhjet e tyre, si për shembull: të parët Zervat vajtur në Sul nga një fshat i Artës i quajtur Zervi, mandej Boçarët nga një fshat i quajtur Dragan "katër orë larg Paramithie", Drakat nga një fshat i quajtur Martan "në krahinën e Lamarit", Buzbat "nga fshatrat e vllehve", Dankliat "nga Fanari" dhe kështu me radhë për gjithsecilin fshat.

Me sa ka qenë informuar në vend, ka përshkruar edhe gjendjen e popullsisë, doket dhe zakonet e saj, Kuvendin e të Parëve, gjykimi i të cilëve ishte ligj për të gjithë suljotët, pacenueshmërinë e gruas suljote që mund të shkaktonte ndëshkime turpi për këdo që do të guxonte ta shkelte etj. Suljotët e gjallë që ka regjistruar ai nuk kanë shkolla, as "letërsi", nuk ushtrojnë zeje as tjetër mjeshtëri, përpos përdorimit të armëve: "me to hanë, me to flenë, me to vigjilojnë".

Jetën e suljotëve nën turkokracinë autori e ka përshkruar në një konflikt të vijueshëm luftarak disadhjetëvjeçar me ushtritë mercenare të pashallarëve dhe më së fundi, edhe me ato të Ali pashës. Përbërja kryesore e atyre ushtrive, sikurse edhe të tjerë autorë e kanë përshkruar, qenë të quajturit "arbërorë turq": τουρκαρβανίτες. Ata qenë rreziku jetik për suljotët, sepse ata përbënin ushtrinë që Ali pasha përdorte për të shtruar të pashtruarit. Nga ana tjetër, edhe për ata *turkarvanites* suljotët nuk qenë veçse "grekë", pra armiq. Një shpjegim të veçantë i ka bërë autori kësaj situate tragjike përçarjeje qysh në pjesën e parë të librit: "Turqit e vërtetë, ndonëse i pushtuan ato vende me fuqinë e armëve, megjithatë nuk iu dukën banorëve të tyre aq mizorë e të pamëshirshëm sa vetë bashkatdhetarët e tyre. Nga kjo merret me mend se përse janë më të neveritshme luftërat e brendshme sesa të huajat.".

Nga një këndvështrim i sotëm, lexuesi është në gjendje ta dallojë që kjo shkimje konfliktuale fetare ishte pjesë e strategjisë së turkokracisë: ajo qe provokuesja e saj duke i ndarë nënshtetasit në *kaurë* (të krishterët) dhe *turq* (myslimanët). Nuk është vendi për të shpjeguar këtu sistemin e mileteve, që besoj se studiohet edhe nëpër shkolla. Por kjo situatë tragjike mund të ndihmojë për të kuptuar se përse jo vetëm te Kristofor Perrevoi si autor, por as tek të tjerë luftëtarë të mëdhenj arvanitë të kryengritjes çlirimtare të Greqisë dhe të Revolucionit grek, nuk mund të kërkohet ajo çfarë nuk gjendet: "Shqipëria". Arvanitë të tillë, sado trima të lavdishëm, luftonin për "atdheun" dhe ky atdhe nuk ishte veçse "patridha", domethënë Greqia. Perrevoi e ka përsëritur më se një herë: "nëna jonë Greqi". Në *Kujtimet* e një tjetri arvanit zulmëmadh, Jani Makrijani, luftëtar e komandant në luftën për pavarësinë e Greqisë i ngritur deri në rangun e gjeneralit, lexohen dëshmi me vlerë për ndërgjegjen e komandantëve arvanitë. Që janë arvanitë ata janë të ndërgjegjshëm dhe e flasin shqipen e tyre më mirë



Portret i autorit Kristofor Perrevó (1773-1863)

se greqishten, sikurse shprehej Odisea Andruco, i cili kur flet për "atdheun" e tij nuk e ka fjalën veçse për Greqinë. Kush ka lexuar veprën kërshërore të Aristidh Koljas, *Arvanitët dhe prejardhja e grekëve*, do të ketë vënë re që autori, vetë arvanit, e ka përshkruar këtë situatë kundërthënëse duke introduktuar një koncept edhe më të avancuar: "ndërgjegjja helene e arvanitëve".

I shfaqur në këtë mënyrë libri dyshekullor i vjetër i arbërorit Kristofor Perrevó rezulton dëshmia ndoshta më e drejtpërdrejtë e historisë së Sulit midis shekujve XVIII-XIX dhe veçan e qëndresës dhe luftërave të suljotëve për të jetuar të lirë në "botën" e tyre.

Asnjë autor që ka shkruar ose do të shkruajë për Sulin dhe suljotët nuk ka se si t'i ikë kësaj vepre. Mund të vihen në diskutim të dhëna të ndryshme të saj, por nuk mund të vihet në dyshim besueshmëria e saj si evidencë. Përkthimi dhe botimi i saj edhe në shqipe – më mirë nga varianti përfundimtar i 1857-s – do ta ndriçonte edhe më një kapitull pa asnjë dyshim madhështisht të bukur të historisë së arbërorëve të Epirit ose arvanitëve.

Se sa i pati mahnitur ky kapitull historie të huajt le të kuptohet nga shënimi i anglezit Thomas de Quincey, të cilit iu pat dukur histori gati e pabesueshme, a thua se "një roman paladinësh", edhe nga aq pak sa qarkulluan përkthimet e saj të vjetra në italisht dhe në anglisht.

ARSHI PIPA

BIBLIOTEKA-MUSEUM E TIRANËS

Bibliotekat, pinatekat, museumet janë institute kulturore ku pasqyrohet jeta mendore e nji kombi. Këtë s'e thomi për vehte, natyrisht, por për ata qi nuk e dinë. E thomi për ata të huej, qi vijshin deri dje me na vizitue si nji vend të rrallë. Gjejshin kta zotnij, lorda plakoça të velun nga mondanitetit, gazetare kulima qi kërkojnë për shtyllat e tyne sensacionalitete, se Shqipnia asht nji vend "piktoreskt", pak "selvaggio" por charmant" n'at "simplicityy"-n e vet natyrale, qi ka thesare të panjohuna bujarije e pyjesh virgjine etj.

Kta zotnij na i marrim për dore dhe i çojmë – jo te Xhamija e Ethem Beut, a te Ura e Brarrit, a te Kalaja e Petrelës, se kto ma i mori vesht bota – por te ndonji prej institutevet tona kulturore të sipërpërmenduna. Dhe u thomi: Urdhnoni, Zotnij, na kemi edhe kësi llojesh tjera!

I çojmë, fjala vjen, te Biblioteka e te Museumi. Asht e vërtetë, spjegojmë atëhere, se na nuk kemi shum biblioteka e museume. Historija e jonë, në robninë e saj pesë herë shekullore... e u thomi ktu at pak fjalë të nevojshme të zakonshme. Veç, shtojmë mandej, nji Bibliotekë e nji Museum i kemi si duhet... E u prijmë për atje. Edhe përjashta kështu bajnë. Kur viziton ndonji qytet, të drejtojnë ma parë kah monumentat ma të përmendun, shtatore, pallate, tempuj, galerina arti. Dihet se kishat janë të stolisuna zakonisht me vepra plastike nga mjeshtrat e medhej. Shpesh, kush ka mndësi, pinakotekat e museumet e edhe bibliotekat, i vendosin ndër pallate historike. Ka lezet e njikohësisht dinjitet qi nji vepër arti të ruhet në nji ndërtesë gjithashtu arti ose në nji tempull. Kështu në Firencë, pinakoteka ma e madhe e Italis ndodhet në "Galleria degli Uffizi", vepër e Vasarit. Në pallatin Pitti ndodhet galerija e artit modern. Verës në kopshtijet e tij epen çfaqje theatrore, dhe në njenën prej sallavet të tija, "Salla e Bardhë", koncerte. Kapela e princave "Medici", ku gjinden disa nga skulpturat ma të bukura të Michelangelos asht në Kishën San Lorenzo. Jo fort larg ksaj kishe ndodhet nji nga pallatet ma të bukura të Rilindjes, pallati "Strozzi". Këtu, tash vonë, vendosën bibliotekën e moçme të "Gabinetit Viesseux". Nji tjetër pallat i vjetër: "Bargello" asht sot museum armësh e veshjesh.

Dhe tash pyesim:

Ata qi e vendosën bibliotekën-museumin kombëtar të Tiranës te binaja e moçme qi qe dikur e princavet Toptanas, a mos u frymëzuan prej nji ideali të këtillë? Bibliotekë e museum! Dy institute kulture të harmonizuem në nji të vetëm! Ekonomi vendi qi i ka hije shijes të madhit burr qi dijti me i vllaznue aq mrekullisht! Bibliotekë e museum bajnë dy. Shto edhe arkitekturën e pallatit ku janë ruejtë, e bajnë tri! Pallati asht në stilin klasik të traditës së madhe qerpiçane: i gjanë e i bollshëm, me çardak sa me nga kuajt, me salla të ndrituna – hygjenikisht – prej shumë dritorevet.

Karakteristikë dalluese: shkallët i ka jashtë dhe i ka, natyrisht, si të gjitha pallatet, simetrike ndër dy anët. Kto shkalla gurit puqen në maje tue përba nën të nji hark qi në thjeshtësinë e vet "austere" ka bukurin e vet. Mbi shkallë, përpara derës së hymjes, stolisë me xhama, çelet nji terracë me parmakë hekuri ndër ana qi përban ballkonin. Prej këndej mund të soditet natyra përqark.

Tash qi ka ardh pranvera asht nji lezet i veçantë me ndje në këtë ballkon e me kënaqë syt me pamjen e oborrit. Pse harrova me ju diftue, pallati ka përpara nji copë oborr, katërkandësh i rregullt, ku bin bari pa pasë nevojë me e lagë.

Për çdo eventualitet ashtu aty, në mes, nji pus, me nji grukë të punueme në relief t'ulët prej daltuesit t'onë ma të përmendun... mjerisht nuk më kujtohet emni. Nuk ka gja ma të kandshme se me kullotë sytë në këtë jeshillëk. Por nuk mjafton. A thash se shkallat janë guri të latuem? Janë kështu për t'u-intonue me arkeologjin e kopshtit! Pse këtu ka pasë kenë dikur nji qytet greko-romak shum i përmendun. Me gërmime të zellshme janë qite në diell disa nga monumentat e vorruem. Kanë zbulue kështu nja disa shtatore pa krena, rrashta pa trupa, nja disa rrasa (jo me la tesha), ndonji qyp i madh për ufull, ndonji mbishkrim turçe qi përmende datën e aleancës së madhe turko romake të vj. 759 p.Kr. etj.

Dojnë me dhane se sidomos nji "palosje" (panneggio) nën balkue, asht i shkollës skopane.

Vendin e nderit e xanë disa cunga shtyllash, mermer i bardhë e laraman, me të cilin stoliseshin tempujt e Afërditës. Kompetentët e deduktojne këtë nga nji bust i gjetun aty pranë, i nji bukurije të rrallë e qi s'mundet me kenë veq se aj i Afërditës. Un jam i mendimit se ato shtylla i përkasin ndonji palestre. Prove qi nuk gabohem asht se pak metra ma lark ndodhet nji "paralele" ku ende të rijt vazhdojnë me ba ushtrime trupore. Nji gja veq më çuditë: si ka muejte me durue, njisoj me shtyllat mermeri, edhe ajo vegël druni! Sidoqoftë kto shtylla, të rëndueme në nji gjysë harku të përsosun, në trajtë orkestre me fëtyre kah dera e oborrit, janë si nji grishje për vizitorin.

I cili teksa hyn, asht i përshendetun prej dy rojevet pa krena, të vueme simetrikisht në të djathtë e në të majtë. Dhe mos të çuditet aspak pse ata janë pa krena! Të hjedhi nji vështrim nëpër kopshte e do t'i gjeje me ndonji skutë, tue kullotë bar! Dhe do të shofi atëhere frona guri të shpërndamë simetrikisht nëpër kopësht, dhe mbi toulun njerëz qi lexojnë ose andrrojnë. Do të ketë përshtypjen se ka hy me nji anfiteatër ku lohet ndonji copë e Eskilit.

Kjo sa për pamjen e jashtme, se për mbrenda, janë mrekullina të tjera. Nuk do të përmendim këtu ç'fat i madh asht për studjuesin me gjetë në nji vend gjana aq të ndryshme si janë libri, shtatoret, parët e yjetra, armët, veshjet e sa tjera. Ai qi don me ba studime krahazuese ndërmjet arteve të ndryshme këtu le të vije. Këtu le të vijë edhe poeti qi kërkon frymzim. N'u lodhtë prej leximit të ndonji librit, i mjafton me shëtitë sytë për rreth për me u dalldisë: këtu nji rrashtë, atje nji kukull, anash nji kanavete, ma tutje trashigimet e Ilirvet. Nji xheverdare kah e djathta, bri saj nji fyell, nji "lakuriq" kah e majta, me nji qoshe nji qyp.

Nuk po flasim mandej për bibliotekën e cila ka ardhë tue u pastrue... deshta me thanë tue u pasunue vazhdimisht, kështu qi sot asht ma e pajisuna bibliotekë në gjithë Shqipnin. Reparti i saj i libravet të vjetër asht jashtzakonisht i pasun. Aq sa disa prej tyne janë të breme prej mijvet.

Bile për punën e mijvet kallxohet nji ndodhi e lezetshme. Pat ardhun do kohë ma parë nji vizitor i huej – italian, me gjasë – të cilit, ndërsa kontrollonte raftet e libravet të vjetër, i pat dale nji mi. Qyqari qe trembe fort e pat ba nji kërcim të madh qi e çoi për rrezik te i vetmi vend i dyshemes qi kishte qillue pak i prishun... E si pat ndodhë edhe pak i randë rande, vojt puna qi aj ra nën aher... Tu lëshuen vrap rojtarët për me i ndihmue rrezikut... kur e gjetën kambë-kryq mbi nji turre librash qi njat-herë sa i kishin prue "taze" prej Distaptur-it tue thithë nji puro!

Por çka dojshin aty turrat e libravet të Distaptur-it, keni me thanë ju?

Fajin e kam vetë qi harrova me ju thanë qysh në fillim se kati i poshtëm i bibliotekë-museum-pinakotekës kombëtare asht depoja e libravet të Ministris s'Arsimit. Eh! po për me ba tamam duhej edhe kjo! Punët e mira a çohen deri në fund a s'fillohen aspak!

I madh kishte pase kenë ky konaku i Toptanasvet,



rueje Zot! Kam kenë e kam shëtitë vetë për gjithë anë. Kaq e shum sende ka zanë e prap zen se zen edhe ma. Kan mbetë kah ana e djathtë nja dy dhoma të vogla bosh. Marr lejen me ba nji sugjerim. Pse me i lane bosh në ket kohë kur po hiqet aq keq me gjetë ndërtesa? Kishe me thanë pra se mund të depozitohen aty edhe nja disa thasë groshe a patate, nga ato të caktueme bje fjala për arsimtarët.

Ka qillue edhe Nozullimi aty pranë, larg dy hapa. Gjynah me e humbë ket rasë!

Kam marrë vesht se nja disa njerëz, qi nuk kuptojne nji xero nga arkeologjija e nga paleologjija, po mundohen me e transferue biblioteke-museumin në nji godinë tjetër, gjoja ma të re e ma të përshtateshme për nji institut kulture të këtillë. Dhashtë Zoti mos ndodhte ky kob! Ata pseudo-artista, kushdo qofshin, të marrun mendsh nga makalushlleqet moderne, nuk po janë në shkallë me kuptue mendimin fisnik t'atyne qi e lanë bibliotekë-museumin për pesmbedhet vjet rresht te ndërtesa e sipërshkrueme. Kjo don me thanë, me nji fjalë, mos me çmue punën e të tjerëvet. Prandaj i drejtohem Kryesis se Shtetit, me nji lutje botore, qi të ndalojë, për të mirë të Kombit e për hir të traditës, çdo veprim "inovator" të kotë, tue e lanë biblioteke-museumin aty ku asht, spakut edhe për nja pesmbëdhet vjet tjera, deri sa të gjindet nji pallat edhe ma i vjetër, ma artistik se ay i Toptanasvet.

Kan mbrrijtë me thanë – o moskuptim i kohnavet t'errta! – se të huejt qi vijnë me na vizitue mund të na tallin për këtë "babiloni" (asht fjala e tyne) kulturë. I nënshkruemi, paleolog i doktoruem pranë "Columbia University", deklaroj solemnisht: Nuk asht e vërtetë. Un, qi ditë për natë, natë për ditë, gjindem në ndonje skaj të bibliotekës, tue kërkue, tue hetue, un qi, kur ishte dimën e ende nuk ishte vue pori në sallën e inkunabujvet, ngrohesha, tue fërkue duert, me zjarrin e kulturës e të historis zamadhe iliro-trake, un arkeologu qi kam shëtitë gjith botën për me ndeshë gjurmat e lavdishme të qytetnimit Shqiptaro-Ilir tue ja zbulue deri në rranzat e Himalaias e deri në Misir, un shkrimtari dorëshkrimet e të cilit presin me u-nxjerrë, kur t'u vijë dita, nga kanaveta e posaçme e Museumit ku janë ndrye e ruejte me kujdes, un pra flas ndryshe. Jam njeriu i bibliotekës e i museumit qysh ditën qi asht themelue. Kam pa me qinda, me mija vizitorësh të huej qi kan hy këtu, kam folë me shumicën prej tyne. Dhe të gjithë nuk kan thanë veç fjalë lavdi e bindjeje për shijen sinkretike, jashtzakonisht të hollë të shqiptarit; i cili në nji kohë kur n'Amerikë hahet dreka në kambë (për me kursye kohë) dhe bahen shtëpijat njiqind katësh (për me kursye vend) paraqitet me këtë vepër të pavdekeshme si ma i madhi ekonomist – artist i shekullit.

Do kohe ma parë, nji mik më ka ba këtë vrejtje: "A nuk të duket se na shqiptaret jemi pak temerare, lamë pasunin e madhe të libravet t'onë në nji ndërtesë të vjetër të cilën mjafton nji shkrepce për me e ndezë si mullar sane, lamë trashigimet e paçmueshme t'arkeologjis s'one nëpër oborre, ku edhe nji hajdut pulash mund të hyjë, tue shkapërcye nji mur t'ultë?" Këtu indinjata ma në fund ka plasë. Por çka kujton ti – kam bërtitë atëhere, – se shqiptari, pinjolli i racës së shkëlqyeshme Ilire, aj qi poeti ma i madh englez, Haroldi, përmende me nderim për trimnin e kalorsin e tij, mundet, guxon, ban sakrilegjin, për me mendue, jo ma me krye kso gjanash? Flet puna vete: tash pesmbëdhet vjet qi biblioteka e museumi janë aty, cili u gjet me marrë e mos me këthye nji libër, ose me zhduke andej edhe vetëm nji pare ari të koleksjonevet? Shpirtin fisnik të Shqiptarit e ka çmue me kohë bota, shpirtin artist të tijin – përveç amerikanvet – e çmojme na vetë.

E të vijë bota tjetër mandej e të thotë se nuk jemi të mëdhej!

(Marrë nga revista "Kritika", nr. 2, prill 1944, rubrika *Jehona kulturore*, botuar nën pseudonimin letrar të prof. Arshi Pipës, shënuar ad literam: CRITICUS)

NJË ROMAN PËRTEJ PROVOKIMIT

Shënime për romanin "Dashuritë e virgjëreshës Madalenë" të autorit Ridvan Dibra

Në vitin 1955, në shtëpitë botuese të Francës qarkullonte një dorëshkrim me përmbajtje erotike që nuk gjente vend për kohën dhe që iu mohua e drejta e botimit pa keqardhje. Shtëpia e vetme botuese që e mori përsipër ishte një zyrë e vogël, e cila shumicën e botimeve të saj i kishte të një përmbajtjeje të fortë erotike. Kjo është historia e ardhjes së "Lolitës" të Nabokovit, libër që është konsideruar nga shumë autorë si një prej veprave më të mira letrare të shekullit XX.

Kurse sot, në vitin 2019, unë mbaj në dorë "Dashuritë e Virgjëreshës Madalenë", shkruar nga Ridvan Dibra. Një libër me natyrë të gjallë provokuese e kontroversale. Në qendër të veprës një personazh me emrin Madalenë dhe që shoqet e thërrasin shkurt Lena. Një Lenë që e shohim tek rritet nëpër tri fazat më kryesore të jetës së saj: moshat 15, 25 e 40 vjeç.

Në vitin e saj të 15-të takojmë një vajzë të brishtë, të ndikuar nga shoqëria dhe që as nuk e imagjinonte sa vendimtare do ishte kjo fazë në të gjithë jetën e saj. Këtu Dibra luan me pasiguritë e moshës, me egon adoleshente dhe me një anë psikologjike që të përball me shumë kurthe. Nis tjetërsimi e absurdi i realitetit, që e çon Lenën drejt një barre ekzistenciale. Në vitin e 25-të kemi një Lenë të hareshme, që besonte te dashuria, në atë të vërtetën ama, por dashuria nuk besoi tek ajo. Në këtë pjesë trajtohet raporti dashuri-mentalitet, frustrimi i një shoqërie të prapambetur që vazhdon të ndikojë te personazhi kryesor. Dibra vazhdon zbërthimin e psikologjisë së gruas dhe nxjerr në pah dramën e saj, duke luajtur edhe më shumë me mendimet e lexuesit. Kurse në vitin e 40-të njihemi me Madalenën, zonjën e vërtetë e të realizuar në të gjitha aspektet, por akoma jo nga dashuria! Në këtë fazë ironia luan rolin e kontradiktës. Është vetë Madalena që dëshmohet kundër unit të saj dhe kështu na paraqitet si një grua të cilën e plotësoi vetë absurdi i jetës. Ridvan Dibra shtron një akt që na vjen si një vetëdije e lidhur drejtpërdrejt me realitetin. Ky autor gjuhën e zotëron me fleksibilitet të plotë, ku stili postmodern përzihet me metaforën erotike për të na dhënë pohime që kanë brenda kontrastin, absurdin. Vërehet se shpeshherë ligjërimi ka gjurmë vulgariteti, gjë që nuk vjen si rastësi, por lidhet me metaforën bazë të romanit. Struktura gjuhësore e përdorur është dinamike dhe e shtyn lexuesin drejt familjarizimit me dimensione të reja. Kjo strukturë e pasqyron denjësisht botën si objekt të veprës, duke gjeneruar më tej kuptimet mbi realitetin.

Karakteristikat postmoderne në këtë vepër lëvizin si në strukturën e brendshme të saj, ashtu edhe në detajet e ndërtimit të jashtëm, duke na treguar një anë spontane ku raporti mimetik i realitetit shfaqet i lirë dhe i natyrshëm. Duket sikur Dibra eksperimenton me një tematikë tabu, por edhe me vetë strukturën e romanit, duke na ndërfutur në një pafundësi qasjesh e mendimesh. Nisur nga konceptimi i strukturës së romanit, shihen disa qëndrime të veçanta e të pazakonta. Prologu në këtë vepër merr një qëndrim krejt ndryshe. Fillimisht, ndërton një formë dialogu paralajmërues me lexuesin. Në vazhdim është në kërkim të një lexuesi ndryshe, një lexuesi që e mban peshën e kuptimit të kësaj vepre. Dibra rrëfimtar njëjtësohet me heroinën e veprës, duke na sfiduar ne si lexues dhe duke thyer kufijtë ekzistentë mes reales e trillit.

Loja letrare na befason: personazhi kryesor bëhet autor i parë dhe vetë autori kthehet në personazh, duke thyer formën tradicionale e duke maskuar kufijtë e një vepre të vërtetë artistike. Nihilizmi shfaqet në dy forma: nëpërmjet neverisë që autori-personazh ndien ndaj absurdit dhe me anë të raportit të krijuar mes realitetit e "banalitetit" që shpesh e mbizotëron ligjërimin letrar. Kombinime të ndryshme brenda një strukture, kalime të papritura nga një periudhë kohore në tjetrën dhe shpërthimet e spektrit seksual e bëjnë këtë vepër të jetë një novacion i letërsisë moderne. Dibra na dhuron një vepër ku kufijtë kohorë e hapësinorë shkrihen, një vepër të mirëfilltë që trajton shoqërinë dhe shuplakat që kjo e fundit hedh pafund drejt gjithsecilit nga ne. Mos vallë Virgjëresha Madalenë është vetë Dibra, apo jemi të gjitha ne, vajzat dhe gratë e shekullit të ri?! Gjatë leximeve të mia kam hasur shumë shkrimtarë që e kanë portretizuar figurën e femrës, por të paktë kanë qenë ata që na e kanë servirur me kaq mjeshtëri psikologjinë e saj, pasigurinë dhe ndjeshmërinë. Nuk do mend, po flas për një shkrimtar që e përdor me aq fleksibilitet metaforën erotike, saqë lexuesi vallëzon me fjalën dhe ndjesinë e dhuruar. "Dashuritë e Virgjëreshës Madalenë" është një trill letrar që të has njëkohësisht me provokimin, por edhe me hezitimin. Një vepër që tenton t'i shkojë deri në palcë shoqërisë shqiptare dhe jo vetëm, duke trajtuar një temë që "fshihet" në skutat më të errëta të njeriut. Kjo vepër vjen si një vullkan i vërtetë social e letrar, që ia vlen të rindizet herë pas here nga lexues të vërtetë.

Alba KALLOGJERI, studente në gazetari

BALLKANI I LUAN STAROVËS

Nga Dr. Silvana Leka

Seria e romaneve të shkrimtarit të mirënjohur Luan Starova po pasurohet përmes përkthimeve në gjuhë të ndryshme të rajonit ballkanik. Së fundmi, shtëpia botuese e njohur kroate *Tim-press* në Zagreb ka publikuar në një vëllim të përbashkët dy romane të këtij autori, duke i botuar për herë të parë si një të vetëm ato që lexuesi shqiptar dhe ai europian i ka lexuar prej vitesh ndarazi. Bëhet fjalë për romanet *Koha e dhive* dhe *Kthimi i dhive*. Nuk është hera e parë që romani kult i Starovës *Koha e dhive* botohet në gjuhën kroate. Kjo vepër e publikuar deri më sot në 20 gjuhë të botës është publikuar në Kroaci edhe dy dekada më parë, si pjesë e edicionit të mirënjohur "romanet-hit". Në të vërtetë, kjo zgjidhje e shkëlqyer editoriale bën të mundur që veprat të funksionojnë si një vijimësi e pandërprerë dhe si vepra në funksion të njëra-tjetrës.

Mbërritja e këtij shkrimtari është përjetuar si ngjarje e rëndësishme letrare dhe kulturore edhe përmes fjalëve të filozofit dhe sociologut francez, të njohur ndërkombëtarisht, Edgar Morin i cili, teksa e paraqet përballë lexuesit francez Luan Starovën, shkruan: "Franca ka zbuluar me habi dhe me emocion shkrimtarin Luan Starova, romancierin e papërsëritshëm, të veçantë si ai, të paklasifikueshëm dhe megjithatë, të mirëvendosur, të mirankoruar."

Pritja e jashtëzakonshme që iu bë që në botimin e parë këtyre veprave vite më parë, zgjoi kureshtje të gjerë edhe për botimet e mëvonshme, përfshi edhe romanin e dytë, titulluar *Kthimi i dhive*. Dihet tanimë se romani *Koha e dhive* u prit mjaft mirë jo vetëm nga lexuesi, por u vlerësua lart edhe nga emrat më të shquar të kritikës së kohës. Mes tyre ishte edhe studiuesi dhe shkrimtari Predrag Matvejević, i cili e përcolli kështu botimin e librit: "Kjo vepër që lindi në kohën e çarjeve ideologjike, ia del të shpërfaqë shumëçka prej kuptimit të kufizuar të realitetit që mund të jetë magjik, si tek G. G. Márquez." Po ashtu, romancieri i njohur Erik Faye thekson në artikujt e tij kushtuar krijimtarisë së gjerë të Luan Starovës: "Letërsitë e Ballkanit na kanë dhuruar përherë perla të vërteta, si romani i Starovës *Koha e dhive*. Lexuesit e Kadaresë, Pekićit ose Stepanovićit, në romanet e tij do të gjejnë edhe një dritare në kulm, të hapur drejt motiveve." Po ashtu akademiku Georgi Stardellov, ndërmjet të tjerash, shkruan për këtë roman: "U rrëmbeva që nga leximi i parë i dorëshkrimit, jo vetëm nga origjinaliteti i temës së tij, jo vetëm nga shtresat e shumta kuptimore dhe etike, por edhe nga shkrimi artistik, në të cilin ndërthuren realja me irealen, historia dhe poezia, tragjedia dhe parodia, realistja dhe fiksioni, epikja dhe lirikja, ajo melankolia andriçiane dhe ajo ironia e heshtur dhe e njohur çingoviane, e gjitha e amalguar në një tërësi komplekse artistike dhe estetike." Në parathënien e botimit grek, Vasilikos, i njohur edhe si skenarist i filmit të famshëm të Kosta Garvrasit "Z", mes të tjerash, theksoi: "E lexova me shumë kënaqësi romanin *Koha e dhive*. Në veçanti më befasoi simbolika dhe butësia e romanit. Është romani i parë që kam lexuar prej Luan Starovës. Ai ka cilësitë e një shkrimtari të lindur. Jam i lumtur që lexova një libër të bukur për Ballkanin tonë të dashur." Shtëpia botuese *Tim-press* botoi më herët në gjuhën kroate edhe romanin *Erveheja – libri për një nënë*, libër ky i shpallur si romani më i mirë i vitit 2005. Romani *Erveheja*... u prezantua përpara publikut lexues të Zagrebit.

Në përurimin e tij, mes shumë emrave të tjerë, foli edhe shkrimtari i njohur në mbarë rajonin, Milenko Jergović. Romani u prezantua me sukses edhe në Panairin Ndërkombëtar të Librit në Pula, ku mori pjesë edhe autori. Për këtë vepër, shkrimtari i mirënjohur francez Filip Delavo shkruan: "Në Sagën ballkanike paraqitet figura e bukur dhe diskrete e nënës Ervehe, shoqëruesja e lexuesit të madh, përherë në shërbim të librave, por edhe si një vitore e rrallë e mbijetesës së familjes. Starova, njësoj si Margerit Jursenari, që shkruan dhe dëshmon para se apokalipsi të zhbëjë reliktet, arkivat e mbrame, gjurmët e venitura të rrugëtimeve." Deri më sot romani *Erveheja*... është përkthyer në gjuhën gjermane, turke dhe bullgare. I njëjti botues (*Tim-press*), në vitin 2018 botoi të përkthyer në kroatisht edhe romanin e katërt të Luan Starovës *Dashuria e gjeneralit* (*Generalova ljubav*), veprën e frymëzuar nga ngjarjet ballkanike në kohën e Luftës së Parë Botërore. Kjo vepër e shquar u botua fillimisht në periudhën e shënimit të përvjetorit të 100-të të Luftës së Madhe (Lufta e Parë Botërore).

Për këtë vepër u shpreh sërish Predrag Matvejević, i cili ka shkruar: "Ky është roman falënderimi për përfaqësuesit e ndershëm dhe të urtë të Francës, të cilët në një periudhë të rëndësishme historike, kur hidheshin themelet e shtetit shqiptar, me guxim dhe të vetëdijshëm e ndihmuan Shqipërinë. Për këtë, dimensioni historiografik i romanit nuk është vetëm plotësim faktografik i personalitetit të Babait... Rrëfimi mbi dashurinë e komandantit Eduard Mortie dhe shqiptares Atina Lazarit meriton rreth të gjerë lexuesish." Ndërkaq, shkrimtari i njohur maqedonas Gane Todorovski, me rastin e botimit të romanit *Dashuria e gjeneralit*, në parathënien e veprës thekson: "Në romanin *Dashuria e gjeneralit* ka një çiltërsi të jashtëzakonshme shpirtërore, një guxim kërlezhian, madje dhe një eurocentrizëm tërheqës, por ka edhe pozicione morale që lënë mbresa të fuqishme. Mbi të gjitha, romani shpërfaq të dhënën se Ballkani nuk është vetëm vend përplasjesh etnike e religjioze, por edhe vend kulturash të ushqyera nga Lindja dhe Perëndimi, Veriu dhe Jugu, duke mundësuar kësisoj jetën e fisme dhe të drejtë."



Poeti i mirënjohur maqedonas Mateja Matevski thekson gjithashtu, duke vënë në dukje vlerat e mëdha të veprës: "Romani *Dashuria e gjeneralit* i ngjan versionit shqiptar të romanit të Tolstoit *Lufta dhe paqja*".

Botimi i këtyre katër romaneve të shkrimtarit të mirënjohur Luan Starova shënon depërtimin e mëtejmë të *Sagës ballkanike* të autorit tonë të njohur në hapësirën kulturore dhe gjuhësore kroate, ashtu siç ndodh me botimin e shumë romaneve të kësaj *Sage* në Francë, Gjermani, Itali, Turqi, Bullgari dhe në disa vende të tjera. Kjo, gjithsesi, është rezultat i qasjes origjinale dhe të sinqertë ndaj një materieje komplekse jetësore, aq të rëndësishme për të ardhmen e popujve ballkanikë dhe Europën. Jo rastësisht, në Francë, ku gjer më tani janë përkthyer dhe botuar më shumë romane të *Sagës ballkanike*, kritika letrare parisiene (*Livres Hebdo*, 8 maj 2009) ato "i vlerëson ndër romanet më të arrira europiane". Dihet tanimë se veprat e Luan Starovës janë pjesë e një koncepti-sagë. Libri i parë i *Sagës ballkanike* është romani *Librat e babait*, botuar më 1992 në gjuhën maqedonase dhe më 1996 edhe në gjuhën shqipe. Deri më sot kjo vepër është botuar disa herë në gjuhën shqipe dhe maqedonase, si dhe shumë herë të tjera në gjuhën frënge, turke dhe italiane. Romani është "matrica" e projektit të prozës romanore të Luan Starovës, strategjia e vetë *Sagës*. Afro pesëdhjetë tregime miniaturale e shpërfaqin gjenezën e pranisë së thuajse të gjithë librave të bibliotekës së babait, të përbashkuar tematikisht, në një renditje shumëkuptimëshe dhe të ndryshueshme. Ky libër i parë i *Sagës ballkanike* shënjon dhe gjurmimin e qartë të një figure simbolike (përkatësisht, të një "metafore globale") – vetë bibliotekës, me libra për dhitë, për ngjalat, për jeniçerët dhe për periudha të caktuara historike të Ballkanit etj. "Këto janë mite të frikshme, - do të vërejë me rastin e botimit të romanit në frëngjisht Yves Bonnefoy, - por janë mite të pasura me shpresë për Ballkanin që e duam, kurse autori bën që ta duam edhe më shumë përpara horizontit të përjetimeve historike, duke ia dalë me këmbëngulësi dhe parimësi të krijojë një vepër monumentale në këto vite të vështira, që ndoshta do të jenë vendimtare për Ballkanin".

Kohët e fundit, krijimtaria e Luan Starovës është bërë e njohur mjediseve të lexuesit përmes revistës "POETEKA", e cila në numrin e saj të 48-të, në verë të vitit 2018 i kushton rubrikën "Personalitet i ftuar" Luan Starovës, duke paraqitur të gjithë opusin prej 17 romanesh të çmuara. Pjesë e këtyre është edhe romani i mirënjohur *Shtegtimi i ngjalave*. Në këtë roman ngjalat e zënë vendin e dhive, si mbretëresha të ujërave liqenore, udhëtimi i fshehtë i të cilave në pjesën ujore të planetit tonë ka domethënie thelbësore në zbulimin e harmonisë ndërmjet njeriut dhe natyrës. Udha që bëjnë ngjalat duhet të jetë paradigmë e udhës të cilën duhet ta bëjë njeriu në planetin tonë, udhë pa kufij dhe pengesa, udhë e lirë e lundrimit të tij në këtë botë…

Autori i këtij romani zbulon se udha e ngjalave është më e vjetër se njeriu, se ajo ekzistonte përpara lindjes së njeriut, prandaj çdo pengim i saj do të jetë tragjik për të. Në këtë udhë të botës ngjalat nisen në të njëjtën mënyrë drejt liqenit, arrijnë nëpërmjet lumenjve në det dhe prej atje shkojnë në Oqeanin Atlantik, arrijnë afër



brigjeve të Amerikës, pastaj, nëpërmjet pasardhësve të tyre, kthehen përsëri nëpër udhën e njëjtë në liqen. Kjo zgjat nga fillet e botës gjer në kohën tonë.

Së këndejmi, përse njeriu nuk i bashkëngjitet udhëtimit të tyre në atë udhëtim kthyes? Nuk duhet harruar se Universi natyror dhe njerëzor është një dhe i vetëm dhe kjo që po ndodh në natyrë mund të krahasohet me frymën e njeriut. Kështu, për të, fenomenet natyrore ndodhin në të njëjtën mënyrë si edhe fenomenet e shpirtit njerëzor. Udhën e ngjalave babai e sheh nga prizmi mitik, përkatësish metafizik, duke kërkuar dalje utopike, duke kërkuar vendin që nuk ekziston (toposin).

Në këtë betejë ai e sheh një epope të madhërishme... Udha e ngjalave për babanë është inkarnacion i gjallë dhe organik i udhës së madhe ndërmjet vdekjes dhe jetës. Ky roman, i përkthyer në gjuhën frënge nga Kleman d'Isartegi, nxiti gjerësisht vëmendjen e lexuesve dhe kritikëve të njohur të *Sagës ballkanike* të Luan Starovës.

Kështu, fituesi i njohur i çmimit Goncourt Moris Droun, për versionin francez të *Shtegtimit* të ngjalave shkruan: "*Shtegtimi i ngjalave* ndërlidhet dhe e plotëson me sukses *Sagën ballkanike* të Starovës. Ajo është vepër alegorike, tejet përfaqësuese në letërsitë ballkanike. Romani shpërfaq një histori tragjike shekullore, që dëshmon për popuj me fate të rënda, i simbolizon familjet e shkulura me shpresa të përhershme kundërthënëse. Ai parashtron njëkohësisht pyetje ekzistenciale dhe metafizike dhe kjo nuk është meritë e vogël." Në romanin *Shtegtimi i ngjalave* Edgar Moren nuk sheh "vetëm një vepër të shkëlqyer letrare, por edhe një krijim me dimensione historike, poetike dhe mitike", ndërkohë që Predrag Matvejević, autori i parathënies së këtij romani, e konsideron veprën si "dëshminë më të rëndësishme për kufijtë e Europës".

Brenda pranverës së këtij viti, romani *Shtegtimi i ngjalave* do të jetë në duart e lexuesit shqiptar nga "Botimet Poeteka", duke çelur kësisoj serinë e romaneve të Luan Starovës dhe rikthim në atdheun e gjuhës së tij. Më herët "Botimet Poeteka" kanë publikuar edhe vëllimin me poezi të Luan Starovës *Kartagjena nuk mposhtet*.

Poeti i shquar Adonis në parathënien e shkruar enkas për botimin në shqip, shprehet: "Në të dukshmen, Luan Starova e vëzhgon të padukshmen. Duke udhëtuar, ai i prek kufijtë e vendqëndrimit... Luan Starova e vështron historinë dhe atë që është përtej saj, udhëtar në vende dhe në kohë. Po ku e shpie, ajo udhë në të cilën niset, ajo, fytyra më bredharake ndërmjet fytyrave që reflektohen në pasqyrën e udhës, udhëtarbanor në çrrënjosje, bredhje dhe dykuptimësi? Kështu poeti flet nëpërmjet Kartagjenës dhe simbolikës së saj të atdheut-nënë të tij, të atyre gjërave që i ka të afërta, ndonëse jeton në çuditshmëri. Ai flet për të tanishmen duke përsiatur mbi të kaluarën."

ZIJA ÇELA
NARRATIVA DHE GROTESKU TE "GOJA E BOTËS"

Nga Enton Bido

Romani "Goja e Botës" (Toena, 2010) i prozatorit të njohur Zija Çela përbën një trilogji, bashkë me romanet e mëparshme "Las Varrezas" dhe "SOS, një buzëqeshje".

Ndër të tjera, në këtë vepër vërejmë këto elemente: intertekstualiteti mes tragjedisë *Hamleti* dhe romanit; romani është polifonik, shumëzërësh; në roman figurat kryesore janë grotesku dhe parodia; teknika e palimpsestit, procedim i njohur në letërsinë moderne sidomos. Ndërhyrjet dhe herë-herë shkrirjet e tragjedisë *Hamlet* me jetën e përditshme të Fifarës. Përdoren motive popullore folklorike shqiptare, si ngjallja e të vdekurit në rastin e Orges Jatës, Zik Kaduku që shkon në Fifara 2 nëpërmjet shpellës, rreziku që i kanoset vajzës së Van Abrashit prej kungullit të varur në traun e shtëpisë, qasjet me legjendat biblike në rastin e plagëve në duart e Desada Stefës në formën e stigmatave etj. Kjo, veç të tjerash, i jep veprës ligjërim etnografik. Ndërhyrjet dhe herë-herë shkrirjet e *Hamletit* me jetën e përditshme të Fifarës. Kotësia e masivizimit dhe amatorizmit në art, gjë që i çon banorët-aktorë në gjendje absurde dhe paradoksale. Ky është edhe burimi kryesor i groteskut në roman. Personazhin e Hamletit e kanë luajtur rreth gjashtëdhjetë veta. Drama e fatit të artistit idealist në mediokritetin e qytezës (Fifarës). Jul Jusit, antiheroi, megjithëse i vetmi aktor profesionist, i duhet të presë tetë vjet për ta vënë shfaqjen në skenë. Rrëfimi është heterodiegjetik. Bëhet autodiegjetik kur flasin personazhet. Fifara është një toponim i trilluar, procedim ky i parapëlqyer nga autori në prozën e tij, si Balbona te "SOS një buzëqeshje", Kukunami te "Las Varrezas", Shën Tirana te "Apokalipsi sipas Shën Tiranës". Në roman ka një toponimi e onomastikë të tërë të trilluar: *Fifara 1, 2*, *Eridriva*, *Goja e Botës*, *Veshi i Botës* etj.; po kështu, të njëjtin funksion ka edhe inventari emëror (lexo: i personazheve) të dorëshkrimit të romanit që ndodhej në muzeun e Fifarës, i cili ishte hartuar nga zoti Abrashi. Lista prej 160 emrash (personazhesh) përmban edhe emrin e autorit, i cili në këtë rast bëhet edhe personazh. Ky procedim i njohur i dorëshkrimit të gjetur është i parapëlqyer në letërsinë moderne. Edhe në letërsinë shqiptare e hasim, p.sh. tek "Arka e djallit" – D. Agolli. Gjuha e pasur, e larmishme, mjaft e përpunuar; shprehjet e ndryshme frazeologjike: *dafrunga*, *thellukat*, *shpatullore*, *mujshi* etj. Ndikimi i realizmit magjik, por jo realizëm magjik i mirëfilltë, duke pasur parasysh se nuk mbështet plotësisht në mitologji në natyrë. Veprën mund ta përcaktojmë si roman metaforik dhe me elemente të ndjeshme fantastike. Ndonjë ndikim nga realizmi magjik nuk mendojmë se e fut veprën në hullinë e kësaj rryme letrare. Këtu kemi parasysh se ndër përbërësit kryesorë të realizmit magjik është mbështetja dhe përdorimi i figurave mitologjike dhe prania thuajse e përhershme e natyrës, apo e përshkrimeve natyraliste. Elemente të tilla janë hasur më herët në prozën tonë te M. Kuteli (*Vjeshta e Xheladin beut*, *E madhe është gjëma e mëkatit*, *Lugetërit e fshatit tonë*) ku, siç është vënë re edhe nga disa studiues, gërshetimi i elementit fantastik, atij mitologjik dhe natyralist, i afrojnë mjaft këto proza me realizmin magjik. Po kështu është hedhur teza e pranisë së kësaj rryme edhe në ndonjë vepër të Kadaresë. Kemi hasur edhe interpretime të tjera për romane të tjera bashkëkohore, që paraqiten si të afërta me realizmin magjik, por që na janë dukur të paargumentuara nga këndvështrimi i letërsisë së krahasuar. Ndoshta kjo bëhet më tepër për t'i ngritur artificialisht vlerat estetike të aksh vepre apo autori, gjë që e dëmton receptimin letrar dhe e fut në qorrsokak kritikën tonë letrare, që edhe pa këtë, ka mjaft mangësi për të ndrequr dhe problem për të zgjidhur. Si përfundim, kemi të bëjmë me një roman polifonik, me narrativë alegorike-fantastike, ku grotesku zë një vend të dorës së parë në rrëfim. Me gjithë problematikën mbarënjerëzore, figurshmërinë e larmishme, zbërthimi i shenjave letrare dhe ligjërimi etnografik e afrojnë veprën me mikrobotën shqiptare. Autori është në pikën e epërme të prodhimit letrar, gjegjësisht të prozës, duke i lëvruar të gjitha llojet e saj. Në romanin në analizë dendësia e rrëfimit, grotesku dhe parabolat fantastike e rrisin më tej korpusin romanor të shkrimtarit Zija Çela, duke e theksuar si një zë të përveçëm dhe përfaqësues të prozës sonë moderniste.



A PO E MUND LETËRSIA GLOBALE LETËRSINË PËR FËMIJË NË SHQIPËRI?!

Nga Gëzim Tafa*

Në të vërtetë, kjo është një pyetje përgjigjja e së cilës nuk të mundon gjatë. Por, më shumë se një studim akademik, kjo trajtesë është një kumt për gjendjen e letërsisë për fëmijë në Shqipëri, udhëkryqet dhe dilemat në të cilat është mbërthyer ajo, dhe që të arrijmë deri te problemet, duhet të kemi të qartë rrugëtimin e saj.

Nëse në botë fillesat e letërsisë, kryesisht moralizuese apo religjioze, i gjejmë diku nga mesi i shekullit të pesëmbëdhjetë, duhet të kemi në vëmendje se pikëtakojnë me kohën kur Johan Gutenbergu e revolucionarizoi procesin e shtypit. Kjo teknologji mundësoi, krahas veprave të letërsisë për të rritur, edhe bashkudhëtimin e procesit të botimit të letërsisë për fëmijë. Dy shekuj më vonë, në vitin 1658, libri i John Amos Omenius, "Orbis Pictus", qarkulloi si libri i parë i ilustruar për fëmijë. Kjo lloj enciklopedie rrëfimtare, e shoqëruar me vizatime, përveç informacionit, ishte edhe një mënyrë për ta lexuar tekstin nëpërmjet imazheve. Ndërsa në shqip gjurmët e krijimtarisë letrare shfaqen rreth dyqind vjet më pas, diktuar nga realiteti historik dhe socio-kulturor. Në këtë kohë "Liza në botën e çudirave" e Lewis Carrol-it ishte botuar dhe qarkullonte e ilustruar mrekullisht nga John Tennie. Është viti 1866.

Katër veprat e Kostandin Kristoforidhit, të botuara nën kujdesin e Shoqërisë Biblike, i njohim si librat e parë në shqip. Por, përtej Adriatikut Jeronim de Rada kishte botuar "Këngët e Milosaos", – saktësisht në Napoli, 1836. Botimet e mëpasshme në histori i njohim si vepra të periudhës së Rilindjes. Deri në mbarimin e Luftës së Dytë Botërore letërsia shqipe, përveç tipareve romantike, ka nota të theksuara të nostalgjizmit patriotik. Këto cilësi i gjejmë edhe më të qarta në krijimtarinë e Naim Frashërit, De Radës, Çajupit, Skiroit, Darës së Ri, Asdrenit e Mjedës, dhe më pas në autorët e Letërsisë së Pavarësisë, te Konica, Fishta, Noli, Migjeni, Poradeci, Kuteli etj. Edhe pse kjo letërsi ndikoi në zgjimin kombëtar, letërsia për fëmijë thuajse është e munguar.

Në vitin 1946 në Shqipëri kishte filluar nga puna shtëpia botuese "Naim Frashëri", me orientim letrar që botonte edhe letërsinë për fëmijë. E vetmja dhe e centralizuar, kjo shtëpi kontrollonte dhe botonte atë letërsi që plotësonte kriteret e dogmës dhe ideologjisë së realizmit socialist. Gjatë ekzistencës së saj janë hedhur edhe bazat e letërsisë "moderne" shqipe për fëmijë. Deri në mesin e viteve 1970 ajo është e orientuar kryesisht te përrallat dhe poezia, dhe më pak te romani, tregimet, fumeti, përshtatjet apo librat e ilustruar me ngjyra. Ajo është një krijimtari që nuk i njeh interesat dhe problemet e moshës, me kufizime të dukshme, me tingëllima naive dhe shpesh banale. Personazhet e kësaj letërsie janë partizanët, heronjtë e punës socialiste, kooperativistët apo nxënësit e dalluar, ndërkohë që bashkëmoshatarët e tyre në botë janë rritur me bëmat e Robinson Kruzosë, Gulliverit, Lizës, Heidit, Gavroshit, Kozetës, Piter Panit, Hirushes, Kësulëkuqes, Pinokut, Bambit, Hakëllberri Finit, Pipi Çorapegjatës, Harry Poterit... dhe lista është shumë e gjatë. Fatkeqësisht, letërsia shqipe ende nuk ka mundur të krijojë një personazh që t'i afrohet kësaj liste.

Nëse trashëguam pak vepra për fëmijë nga kjo krijimtari, është interesant fakti se editoria private shqiptare nuk lindi si një zgjatim i konceptit botimor dogmatik të shtëpisë botuese "Naim Frashëri". Dëshira për të kapur kohën e humbur mundësoi që gjithçka që botohet në Perëndim, në kohë reale të vijë edhe në shqip. Falë profilizimit dhe një filozofie të qartë, edhe pse në një treg të çorientuar e pa rregulla, botuesit e librave për fëmijë e kanë ngritur standardin e përfaqësimit. Por, ashtu si letërsia shqipe për të rritur, edhe kjo letërsi vuan nga e njëjta diagnozë. Mospërshtatja, mbetja jashtë ritmeve dhe interesave të letërsisë globale, e mbyllur brenda një tregu të kufizuar në këtë territor të vogël ballkanik, me barriera artificiale, pa vëmendjen e institucioneve, të dashamirësve dhe lexuesit.

Në vitin 1969, në vitin e 150-vjetorit të botimit të parë, botuesi i "Random House" e ftoi Salvador Dalinë e madh që të ilustronte me ngjyra me 12 heliogravura librin "Liza në botën e çudirave". Në frontespic, botuesi zgjodhi një gravurë origjinale me firmën e Dalisë. Prej kësaj strukture, ky edicion u kthye në ngjarje që i tejkaloi të gjitha pritshmëritë. Bashkëpunimi i Dalisë me "Random House" vazhdoi edhe me ilustrimin e librave të tjerë, si "Romeo dhe Zhuljeta" e Shekspirit apo "Kuzhina erotike".

Në vitin 1955, një tjetër spanjoll, gjeniu Pablo Picasso, kishte realizuar për "Le Lettre Françiase" trembëdhjetë grafika bardhë e zi dhe me ngjyra të "Don Kishotit të Mançës". Ndryshe nga struktura piktorike blu apo kubiste, ato kishin tendencë ekspresive. Dali e kishte ende të freskët jehonën e kësaj ngjarjeje të Picasso-s, ndaj i propozoi shtëpisë botuese "Random House" botimin në anglisht të kësaj kryevepre të letërsisë spanjolle me ilustrimet e tij. Edhe ky homazh për Servantesin garantoi sukses absolut.

E solla në vëmendje këtë rast, sepse dua të ndalem në marrëdhëniet që individë apo institucionet e vendeve të ndryshme tregojnë për mbështetjen dhe promovimin e letërsisë së tyre. Shumë syresh, nëpërmjet projekteve, mbështesin edhe në gjuhë më të vogla publikimin e letërsisë klasike dhe bashkëkohore. Po me letërsinë tonë për fëmijë çfarë ndodh sot?

Në studimin "Koncepti i fëmijëve mbi botën", në kapitullin mbi zhvillimin psikomotor të fëmijëve, psikologu zviceran Jean Piaget thotë: "Fëmijëve duhet t'u lexojmë që në ditët e para të jetës, jo më pak se njëzet minuta. Kur fëmija është në moshën 0-1 vjeç duhet t'i këndojmë ninulla. Në moshën 4 vjeç atij duhet t'i lexojmë tekste me ilustrime me ngjyra dhe me fabul të shkurtër, ndërsa kur është 4-5 vjeç duhet t'i mësojmë rimat."

Personalisht, unë mendoj se ky kujdes përgatit të dashuruarit me leximin. Rreth pesëdhjetë vjet më parë, mësuesja ime e kopshtit në qytetin tim të lindjes më ka mësuar: *Ylli i vogël lart në qiell/ dukesh porsi zjarr në pyll...* të K. Kristoforidhit. Jam i bindur se mësuesja ime e dashur nuk ka pasur asnjëherë rast që ta njohë psikologjinë e Jean Piages... por fakti që do t'ju lexoj më poshtë më trishton. Sot fëmijët 4-5-vjeçarë, në sistemin parashkollor, në kopshtet tona shtetërore dhe private këndojnë në kor rima të tilla: *Këmba para, këmba mbrapa/ këmba majtas, këmba djathtas/ Dora para, dora majtas/ dora lart, dora poshtë/ Kërcejmë hop-hop-hop/ këmbët i përplasim...*

Më falni, por do ta bëj një lutje: "Zot, shpëtoje lexuesin e së nesërmes prej kësaj marrëzie."

Por, në historinë e letërsisë sonë mungon një Ezop, një Andersen, një Defo, një Barri, një Kipling, një Caroll apo një Joan Rolling. Këtij fakti i shtoj edhe klimën e botimeve në përgjithësi. Nëse në raftet e librarive në të gjithë Shqipërinë vështirë se gjen ndonjë libër për fëmijë të një autori shqiptar, vargjet me këmbë dhe me duar që citova më sipër, janë marrë nga një botim që shitet me disa mijëra kopje prej vitesh nëpër kopshte. Ky (këto) libër mban autorësinë e metodistëve që hartojnë politikat dhe kurrikulat e arsimit parauniversitar dhe që nuk kanë lidhje me letërsinë. Veçse kjo gjëmë rëndohet edhe më shumë në tekstet e shkollave nëntëvjeçare e të mesme, hartuar pa filtra dhe të denatyruara.

Nga ana tjetër, duhet të pranojmë se ka një realitet dhe një standard kulturor krejt të ndryshëm të fëmijëve tanë nga yni apo i shumë shkrimtarëve të letërsisë për fëmijë. Ata kanë diferenca kulturore, janë më të informuar dhe e zotërojnë teknologjinë e hi-techut. Komunikimi apo lundrimi në mediume të njëjta me bashkëmoshatarët e tyre në botë u jep të drejtën për të qëmtuar edhe në veprat e letërsisë bashkëkohore a klasike. Ata janë të lirë për të zgjedhur, çka është më e nevojshme dhe e shëndetshme. Si përfundim: Letërsia shqipe për fëmijë është në betejë me letërsinë globale!

** Shtëpia e librit OMBRA GVG*

DRIANT ZENELI
FËMIJËT E MINIERAVE TË BULQIZËS NË BIENALEN E VENECIAS

Nga Fatmira Nikolli

Ndodhemi në Bulqizë pranë minierave dhe kemi përballë 5 heronj. Janë pesë fëmijë që ecin nëpër zonën e minierës, zbulojnë një kapsulë kozmike dhe duan të ikin prej aty. "Vepra flet për 5 astronautë të vegjël që gjejnë një kapsulë dhe nisin udhëtimin e tyre. Udhëtimi i tyre ndiqet nga një person i gjashtë". Artisti Driant Zeneli e shpjegon kështu këtë pjesë të veprës me të cilën Shqipëria shkon në Bienalen e Venecias. A është përfshirë në të drama sociale e fëmijëve të Bulqizës? A është përfshirë drama e një qyteti si Bulqiza apo drama e një qyteti si Elbasani me ndotjen e madhe për shkak të Metalurgjikut? A i prek vepra problemet tona?

Drianti thotë se përballë tragjedisë së të tjerëve secili ndihet ndryshe. "Edhe në revista ke në një krah tragjedinë dhe në anën tjetër është reklama. Disa prej nesh e shohin. Jam shumë i interesuar për aspektet sociale e politike. Krijoj narrativë paralele duke luajtur mes reales dhe fiksionit. Ka momente që biem e që ngrihemi. Kjo s'do të thotë që vepra nuk prek. Kjo s'do të thotë që s'po flas për situatë sociale. Por edhe si mund të ripërdoret situata sociale dhe si mund të ripërdoret metalurgjiku", - tha ai. Ndërsa kuratorja Alicia Knock tha se Drianti ndërton triologji. "Ideja si gjëja lokale bëhet globale. Është e bukur të punosh me një projekt me këtë titull dhe kthehesh në një kohë që Shqipëria s'mund të shihte disa gjëra dhe ishte e mbyllur". Sa i takon anës sociale ajo tha: "...nuk duhet të mohosh kaosin. Ne mund të fluturojmë. Ne mund ta provojmë. Ajo që ndiej është se ky projekt është shumë fiksional, tragjik dhe pothuaj pesimist." Kështu u shpreh ajo duke folur për fëmijët e Bulqizës që duan të udhëtojnë e të ikin. Konck tha se ky është udhëtim në hapësirë për ata fëmijë që s'mund të lëvizin tokën jo më kozmosin.

VEPRA

Pavijoni shqiptar në Bienalen e Venecias i takon Driant Zenelit me titullin *Maybe the cosmos is not so extraordinary*. Këtë vit pavijoni qëndron hapur në datat 11 maj-24 nëntor 2019. "Ndoshta kozmosi nuk është aq i jashtëzakonshëm", një projekt i artistit Driant Zeneli, kuruar nga Alicia Knock. Si i shtyjmë kufijtë tanë fizikë dhe mendorë pa u bërë superheronj? A mund të bashkëjetojnë e mundura/ realja dhe imagjinarja? Në thelb të hulumtimit të Driant Zenelit qëndron ripërkufizimi i dështimit, utopisë dhe ëndrrës. Nëpërmjet rrëfimit filmik dhe performancës, Driant Zeneli sfidon përpjekjen ngulmuese të njerëzve ndaj kufijve të tyre, duke nxjerrë në dritë përgjigjet e mundshme të brishtësisë së qenieve njerëzore dhe planetit Tokë. Ai sfidon marrëdhënien fizike dhe metafizike midis njeriut dhe hapësirës, materies dhe ëndrrës, gravitetit dhe kontrollit. *Maybe the cosmos is not so extraordinary* (2019) është një video-instalacion skulpturor, i cili bazohet në një projekt shumëdisiplinar emërtuar *Beneath a surface there is just another surface*, që nisi në vitin 2015 në Metalurgjik, një kompleks industrial dystopian, në qytetin e Elbasanit në Shqipëri. Projekti dhe titulli i tij rrjedhin nga novela fanatastiko-shkencore "Drejt Epsilonit të Eridanit" (1983) e shkruar nga fizikani dhe shkrimtari shqiptar Arion Hysenbegas. Instalacioni zhvillohet nga një film me dy kanale, ngjarjet e të cilit zhvillohen në minierat e Bulqizës, një qytet në verilindje të vendit, ku, që prej vitit 1918, është nxjerrë minerali i kromit.

Kromi përbën një burim kryesor për zhvillimin industrial të Shqipërisë dhe bie ndesh me përplasjet ekonomike dhe politike në Jugun Global (botën në zhvillim). Filmi paraqet një grup adoleshentësh nga Bulqiza që zbulojnë një kapsulë kozmike, e cila ndjek udhëtimin e kromit, nga nxjerrja dhe përpunimi i tij brenda fabrikës deri në eksportimin dhe shfrytëzimin e tij në mbarë botën. Prandaj ky udhëtim hapësinor "gjeopolitik" e kthen këtë mjedis industrial të errët dhe dramatik në një hapësirë shumëvlerëshe për kolaps dhe fluturim. Nëpërmjet rrëfimit binar, koreografisë së përpiktë të pamjes dhe zërit, fabrika mbarëvepron jo vetëm si një hapësirë industriale apo qendër gjeopolitike, por edhe si një forcë pamore performuese. Nxjerrja e kromit shndërrohet në një pamje skulpturore hipnotike dhe si pasojë, e tërë fabrika përkthehet në një instalacion të madh "paralel" të dritës dhe zërit, i vulosur organikisht në muret e Arsenales. Në këtë hapësirë produktive dhe magjepsëse, Driant Zeneli synon të krijojë tension midis një realiteti shtypës nëntokësor dhe një hapësire utopike të mundësisë dhe çlirimit. *Maybe the cosmos is not so extraordinary* përpiqet të zbulojë fizikisht aftësinë e së zakonshmes, madje edhe në qoshet e saj më të errëta, për të zgjeruar qenien tonë.

Driant Zeneli (lindi në vitin 1983, Shkodër, Shqipëri) jeton dhe punon mes Tiranës dhe Milanos. Në vitin 2008 fitoi çmimin ndërkombëtar të artit bashkëkohor "Onufri", në Tiranë; në vitin 2009 çmimin e artistëve të rinj europianë "Trieste Contemporanea" dhe në vitin 2017 çmimin "MOROSO", Itali. Ai ka qenë drejtor artistik i bienales së artistëve të rinj nga Europa dhe Mesdheu, "Mediterranea 18", që u zhvillua për herë të parë në vitin 2017 në qytetet e Tiranës dhe Durrësit. Është bashkëthemelues i Platformës së Artit Bashkëkohor Harabel në Tiranë. Veprat e tij janë paraqitur në: GAMeC, muze i artit modern dhe bashkëkohor, Bergamo (2019); Passerelle, Centre d'art contemporain, Brest (2018); Mostyn Gallery, Uells, Britani e Madhe (2017); MuCEM, Marsejë (2016); Academie de France à Roma (2016); Centre Pompidou, Paris (2016); IV Bienal del Fin del Mundo, Kili (2015); GAM, muze i artit modern dhe bashkëkohor, Torino (2013); White House Biennial, Athinë (2013); KCCC, Klaipeda, Lituani (2013); ZKM, Karlsruhe (2012); MUSAC, Castilla León, Spanjë (2012); Bienalja e Pragës 5, Pragë (2011); Trongate 103, Glasgou (2011); Galeria Kombëtare e Kosovës, Prishtinë (2010); Museo d'Arte Contemporanea Villa Croce, Genoa (2009); Galeria Kombëtare e Tiranës (2008).

Lindur në Arequipa (Peru) më 1936, Mario Vargas Llosa është romancier i më shumë se njëzet veprave madhore midis të cilave spikatin "Qyteti dhe qentë", "Teto Julia dhe shkresaxhiu" (Çmimi i romanit më të mirë të huaj), "Lufta e fundit të botës" (Çmimi Ritz-Hemingway), "Fletorkat e Don Rigoberto-s" (1988), "Një barbar te të qytetëruarit" (1988), "Utopia arkaike", (1999), etj.

MARIO VARGAS LLOSA

ELEMENTI I FSHEHUR

Letër një romancieri të ri

I dashur mik.

Ernest Hemingway-i tregon diku se në fillesat e veta letrare, teksa hidhte në letër një rrëfenjë, papritmas i qëlloi që të shuante ngjarjen kryesore, që protagonisti varte veten. Ai tha se zbuloi kësisoj një mënyrë rrëfimtarie, të cilën do ta përdorte gjithmonë e më dendur në të ardhmen për të mbrujtur novelat e romanet e veta. Në të vërtetë, nuk teprohet aspak nëse thuhet se rrëfimet më të arrira të Hemingway-it janë të stërpikura me heshtje shumëçkathënëse, me grimca fshehatare të një rrëfimtari mëndjehollë, i cili ia del mbanë që të dhënat e veshura prej atij vetë me petkun e heshtjes, të jenë megjithatë sa më shprehëse dhe të shtien medoemos në ngasje përfytyrimin e lexuesit. Kështu, ky i fundit duhet t'i mbushë këto golle të historisë me hamendësime e përgjasmime të mendjes së tij. Le ta quajmë këtë mënyrë "elementi i fshehur" e të saktësojmë menjëherë që, paçka se Hemingway-i i ka bërë kësaj një lëvrim vetjak e të shumëfishtë (herë-herë mjeshtëror), nuk është ai që e ka shpikur, meqë kjo është një teknikë e moçme sa vetë romani.

Mirëpo, është mëse e vërtetë që fare pak shkrimtarë modernë e kanë përdorur me guximin e autorit të "Plaku dhe deti". A ju kujtohet ajo novela mjeshtërore, mbase më e famshmja e Hemingway-it me titull "The killers" (Vrasësit)? Gjëja më me rëndësi e rrëfenjës është kjo pikëpyetje e madhe: përse kaçakë me çifte tytësharruara hyjnë në restorantin e vogël Henry's të asaj krahine pa emër dhe duan të vrasin suedezin Ole Anderson? Dhe, përse ky Ole Anderson i fshehtë, ndërsa djaloshi Nick Adams e paralajmëron se dy vrasësit po e kërkojnë për ta qëruar, nuk pranon t'ia mbathë a të verë në dijeni policinë, por i bindet me fatalizëm fatit të vet? Ne nuk kemi për ta marrë vesh kurrë. Nëse na i ka ënda ndonjë përgjigje për këto dy pyetje boshtore të rrëfenjës, ne duhet ta sajojmë vetë, si lexues, duke u nisur nga thërrmijëzat që rrëfimtari – në dijeni të gjithçkaje e jovetjak – na jep aty – këtu; Para se të vinte në këtë qytezë, suedezi Ole Anderson ka qenë, me ç'duket, boksier në Chicago, ku ka bërë diçka, (diçka që s'i ndezi, thotë ai) e cila ka nënshkruar dënimin me vdekje.

Elementi i fshehur a rrëfimi i jashtëlënë nuk është për së koti a arbitrar. Lypset që heshtja e rrëfimtarit të jetë domethënëse, që ajo të ushtrojë një ndikim të spikatur në pjesën e shprehur qartas të rrëfenjës, me qëllim që kjo mungesë të ndihet kthjelltas e të përndezë kërshërinë, pritjen dhe përfytyrimin te lexuesi. Hemingway-i qe mjeshtër i pashoq në përdorimin e kësaj teknike rrëfimtare, siç bie haptas në sy te "The killers", shembull sqimatar i kursimtarisë rrëfenjëse, tekst që është porsi maja e një ajsbergu, një buitje pipiruqe e mezidallueshme që mundëson ndërdukjen në mënyrë mahnitëse të gjithë ngrehinës plotësore anektodike ku mbështetet bëshëm, por që i është fshehur lexuesit. Të rrëfyerit duke heshtur me anë të nënkuptimeve që e shndërrojnë brendastrukjen në pritje përcëllitëse, duke e nxitur lexuesin të ndërhyjë gjallërishëm në rrjedhat e rrëfimit, përmes përgjasmimeve e hamendësimeve të veta, përbën një përdorim shpeshtësor te rrëfimtarët për të ndërfutur lëndë të vetëjetuara në thurimat e tyre, domethënë i pajisin me fuqi bindshmërie.



A ju kujtohet elementi i madh, i fshehur i romanit më të mirë (për mendimin tim) të Hemingway-it "Dhe dielli lind përsëri"? Po, atë vetë: pafuqinë e Jake Barnes-it, rrëfimtarit të romanit. Ajo nuk jepet kurrë haptas: ajo gëlon papritmas – e marr guximin thuajse të them që lexuesi i cytur për çka lexon, ia mvesh personazhit – nga një heshtje kumtuese, kjo largësi e çuditshme fizike, lidhja e dlirë mërshore që e bashkonte me bukuroshen Brett, femra që ia bën zemrën zhur e që mbase e do dhe vetë ai që mund të kish dashur, ishte, pra, vetëm një pengesë a ndalim, për të cilin ne nuk kemi qënë kurrë me saktësi në dijeni. Pafuqia e Jake Barnes-it është një heshtje jashtëzakonisht e qartëshprehur, një mungesë që vjen e bëhet gjithmonë e më shprehëse sa më shumë që lexuesi të çuditet nga qëndrimi jo i zakontë e kundërshtues i Jake Barnes-it karshi Brett-it, derisa i vetmi shpjegim i mundshëm të mbetet zbulimi (shpikja?) e pafuqisë së tij. Paçka se e hedhur në heshtje a ndoshta, pikërisht nga vetë mënyra se si është, ky element i fshehur e pranon thurimën e "Dhe dielli lind përsëri" me një vezullim shumë të veçantë.

"Xhelozia", e Robbe – Grillet-së është një tjetër roman ku një tjetër përbërës themelor i rrëfenjës – jo më pak se personazhi qëndror ka mërguar nga rrëfimi, por në mënyrë të atillë që mungesa e tij është mpleksur në tejzat rrëfimtarë, aq shumë sa të ndihet ndjeshëm orë e çast. Ashtu si, pothuajse në gjithë romanet e Robbe – Grillet-së, te "Xhelozia", nuk ka rrëfenjë në kuptimin parësor të fjalës, ca më pak, siç kuptohej në mënyrë tradicionale – një subjekt me fillim, shtjellim e përfundim – por më së shumti, syrsa a simptoma të një rrëfenje që nuk e njohim dhe, të cilën jemi të detyruar ta rindërtojmë ashtu siç ringrejnë arkeologët pallatet e babilonasve vetëm duke u nisur prej një grusht gurësh të rroposur nga shekujt, ose, si zoologjistët kur ribëjnë dinosaurët e zvarranikët fluturues të prehistorisë, duke

u mbështetur te një hekës a metakarp. Aq sa ne mund të themi se romanet e Robbe – Grillet-së janë mbujtur që të gjithë mbi bazën e elementëve të fshehur. Kështu, te "Xhelozia" kjo mënyrë shkruarjeje është veçanërisht funksionale sepse, që ajo çka tiret aty të ketë kuptim, lypset medoemos që kjo mungesë, kjo qënie e zhbërë, të bëhet e pranueshme, të marrë trajtë në ndërgjegjen e lexuesit. Cila është kjo qënie e padukshme? Një bashkëshort xheloz, siç e lë të nënkuptohet vetë titulli i librit, përmes kuptimit të tij të dyvlershëm, dikush që, i pushtuar nga demoni i mosbesimit, përgjon si i marrepsur të gjitha lëvizjet e gruas, pa i rënë asaj në sy. Lexuesi nuk e di me siguri këtë gjë. Ai e nxjerr a e sajon, i prirur nga natyra e përshkrimit, që është natyrë e një vështrimi të bezdisshëm, të molepsur, të lajthitur, të paracaktuar për kqyrje imtësore të zhvendosjeve më vocërrake, veprimeve dhe lëvizjeve të bashkëshortes. Kush është ky vëzhgues matematik? Përse ia nënshtron ai këtë grua këtij rrethimi pamor? Këto grimca të fshehura nuk gjejnë përgjigje brendapërbrenda ligjërimit romanor dhe është vetë lexuesi ai që duhet t'i ndriçojë duke marrë shtysë nga hullizat rrallacake që romani i jep për shqyrtim. Këto elementë përfundimisht të fshehura, të hequra për fare nga një roman, ne mund t'i quajmë "eliptike", për t'i dalluar nga elementët që i qenë fshehur lexuesit vetëm përkohësisht, zhvendosur në kronologjinë romanore për të përftuar pritje dhe frymëpezulli, siç ngjet me romanet policorë ku vrasësi zbulohet vetëm në fund. Këta elementë të fshehur për një çast – të zhvendosur - , ne mund t'i quajmë "elementë të fshehur në hiperbat", figurë poetike që, siç mund të kujtohet, përftohet nga zhvendosja e një fjale në varg për qëllime eufonie a rime ("E lulëzuara stinë e vitit ish…" në vend të rradhitjes së rregullt: "Ish stina e lulëzuar e vitit…"1).

Ndoshta, më i shquari element i fshehur i romanit modern është pikërisht ai që hasim tek "Altari" i llahtarshëm i Faulkner-it, ku "krateri" i historisë – zhvirgjërimi i rioshes dhe mëndjelehtës Temple Drake nga Popeye, horr i zgërlaqur e i krisur me anë të një kalliri misri – është zhvendosur dhe shtrirë në grimca të dhënash, të cilat e shtyjnë lexuesin ca nga ca e duke shtegtuar në të shkuarën, të bëhet i vetëdijshëm për ngjarjen e lemerishme. Kjo heshtje e krupshme e pushton mjedisin ku llokoçitet "Altari": atmosferë egërsie, dhune seksuale, drithërime, paragjykimesh e primitivizmi që i jep Jefferson-it, Memphis-it dhe viseve të tjera të rrëfenjës, karakterin simbolik të universit të së keqes, të zhbërjes së njeriut dhe të rënies së tij, në kuptimin biblik të fjalës. Më shumë se sa një shkelje e ligjeve njerëzore, përshtypja që na mbetet duke lexuar lebetitë e këtij romani – përdhunimi i Tempullit nuk është gjë para tyre, pasi ka, për më tepër, varje, shkrumbim në zjarr, vrasje të ndryshme dhe një mori e shumëllojshme rrënimesh morale – është, pra, përshtypja e një ngadhnjimi të fuqisë së ferrit, e një disfate të së mirës përmes një tronditjeje të përgjithshme plasaritëse që ia ka dalë mbanë të mbërthejë mbarë tokën. Gjithë "Altari" përbëhet nga elementë të fshehur. Përpos përdhunimit të Temple Drake-s, fakte po aq të rëndësishëm sa vrasja e Tommy-t dhe e Redi-t a pafuqia e Popeye-it janë së pari, heshtje, heqje që i zbulohet lexuesit vetëm retrospektivisht. Ky, në këtë mënyrë,falë këtyre elementeve të fshehur si hiperbat, e kupton saktësisht se çfarë ngjet dhe ndërton kronologjinë e njëmendët të ngjarjeve. Faulkner-i, jo vetëm këtu, por në të gjitha veprat e veta, qe gjithashtu një mjeshtër i përkryer i elementit të fshehur…

Kështu, pra, qoftë edhe me kqyrjen e ndonjë pjese të vetme të një libri klasik, ne vëmë re se burimet dhe mënyrat e rrëfimtarisë që në të shumtën e herës shëmbëllejnë me shpikje moderne nga përdorimi largpamës që u bëjnë shkrimtarët bashkëkohorë, i përkasin në të vërtetë, trashëgimisë romanore, sepse romancierët klasikë i kanë përdorur ato më parë



me shumë lirshmëri. Ajo çka kanë bërë modernët, në shumicën e rasteve, është se kanë lëmuar, kanë tëholluar e zbatuar mundësi të reja strukur thellë nëpër sisteme rrëfimtarie, behur shpesh e më shpesh nga shfaqjet më të moçme shkrimore të trillimtarisë.

Para se ta përfundoj këtë letër, do t'ia vlente ndoshta barra qeranë të bëhej një përsiatje e përgjithshme, e vlefshme për të gjithë romanet, mbi një karakteristikë të lindur të gjinisë nga ku buron mënyra e kutisë kineze. Pjesa e shkruar e çdo romani është vetëm një grimë a një pjesëz e ngjarjes së rrëfyer: kjo, e shtjelluar në tërësinë e saj, me grumbullimin e të gjithë përbërësve të vetë pa përjashtim – mendime, xheste, sende, të dhëna kulturore, materiale, historike, psikologjike, ideologjike etj., që hamendëson e përmban historia "tërësore" – përfshin një lëndë pafundësisht më të gjerë sesa ajo e dhënë haptas në tekst dhe që asnjë romancier, qoftë edhe më fjalëshumi i rrëmbyer, nuk do të qe në gjendje ta shpalonte.

Për të nënvizuar këtë karakter pashmangërisht të pjesshëm të çdo ligjërimi rrëfimtar, romancieri Claude Simon - të cilit ia kish ënda të qesëndiste grefosjet e letërsisë "realiste" për të riprodhuar realitetin – përdorte një shembull: përshkrimin e një pakete cigaresh "Gitanes". Cilët elemente duheshin përfshirë në këtë përshkrim që ai të jetë realist? pyeste Simon-i. Përmasa, ngjyra, përmbajtja, shkrimet nëpër kapakë, vetë lënda e paketës, afërmendsh. A do të qe vallë kjo e mjaftueshme? Në një kuptim përplotësor, kurrsesi. Do të duhej gjithashtu, për të mos hequr a cënuar asnjë element me rëndësi, që përshkrimi të përmbante të dhëna sa më të hollësishme për mënyrat industriale të prodhimit të kësaj pakete dhe të cigareve që kishte ajo, madje, (përse jo?) për sistemet e shpërndarjes dhe të tregtimit që i përcillnin nga prodhuesi gjer te konsumatori. Mos, vallë, përshkrimi "përplotësor" i paketës së cigareve"Gitanes" do të merrte fund me kaq? Sigurisht që jo. Konsumimi i cigareve nuk përbën një fakt të veçuar, ai rrjedh nga përparimi i zakoneve dhe i rrënjosjes së modave, lidhet ngushtësisht me historinë shoqërore, me mitologjitë, politikat, mënyrat e jetesës së shoqërisë. Nga një anë tjetër, bëhet fjalë për një praktikë- zakon a ves – tek i cili reklama dhe jeta ekonomike ushtrojnë një ndikim vendimtar dhe që përçon efekte të përcaktuara në shëndetin e përdoruesit. Nuk është, pra, e vështirë të nxirret përfundimi, duke e shtyrë këtë shpalim gjer në caqet e absurdes, që përshkrimi i çdo objekti, dhe i më të papërfillshmit, i shtrirë në një rrafsh përplotësor, çon thjesht e qartas te ky pretendim utopik: përshkrimi i mbarë gjithësisë.

Pa dyshim, që po kështu mund të flitej edhe për trillimtarinë. Në qoftë se një romancier, në çastin kur nis e shtjellon një rrëfenjë nuk do të vetëmjaftohej me një mori caqesh (e thënë ndryshe, nëse ai nuk do të pranonte t'i fshihte disa elemente) atëherë rrëfenja nuk do të kishte, as kokë, as bisht, nuk do të mundëte kurrësesi të ndërthurej me të gjitha rrëfenjëzat, për t'u bërë ajo përplotëri magjiplotë, univers i pafund përfytyror ku bashkëjetojnë, lidhur thellësisht vetiu të gjitha trillimtaritë.

Kështu, pra. Në qoftë se pranojmë mendimin që një roman – a më mirë të themi, një trillim i shkruar – është vetëm pjesëz e rrëfenjës plotësore, së cilës romancieri gjendet fatalisht i shtrënguar t'i krasitë elemente të panumërta, të tepërta a që mund të lihen mënjanë, paçka se të ndërdukshme në ato çka ai shtjellon haptas, lypset medoemos të dallohen këta elemente të përjashtuar, meqenëse të spikatur a të padobishëm qofshin, janë elemente të fshehur të cilëve u përmbahet kjo letër. Në fakt, elementet "e mi' të fshehur nuk janë, as të theksuar, as të padobishëm. Përkundrazi, ata janë funksionalë, luajnë rol të posaçëm në thurimën rrëfimtare dhe pikërisht për këtë gjë shuarja a zhvendosja e tyre përçon ndikesa në rrëfim, duke kumbuar bujshëm kah anekdota a te pikëpamjet.

Më së fundi, do të ma kishte fort ënda, t'ju përsëris një krahasim që e kam bërë hera-herës duke komentuar "Altari"-n e Faulkner-it. Le të themi që rrëfenja "e plotë" e një romani (e përbërë nga elemente të përfshirë a të hequr) është një kub. Dhe që çdo roman i veçantë, me t'iu qëruar elementet e tepërt e ata të hequr shpengueshëm për të përftuar një efekt të përcaktuar, të nxjerrë nga ky kub, merr një trajtë të përcaktuar: ky objekt, kjo skupturë, pasqyrojnë origjinalitetin e romancierit. Trajta e tij është gdhendur me ndihmën e mjeteve të ndryshme, por, pa as më të voglin dyshim, njëri nga më të përdorurit e tejet të vlefshëm për këtë punë, ai i tëharrjes së përbërësve gjersa ravijëzohet profili i figurës së hijshme e bindëse që na bën për vete, është pikërisht elementi i fshehur (nëse nuk keni ndonjë emër tjetër më ngasës për t'i vënë këtij mjeti).

Miqësisht i juaji gjer në një
bisedë tjetër për së shpejti
Mario Vargas Llosa

Përktheu: Luan CANAJ

KADARE

proza e shkurtër

në një vëllim

Onufri